



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 585/ Prot.
11

Tiranë, më 06/03 /2023

VENDIM

Nr. 04, datë 06.03.2023

PËR

**MIRATIMIN E RAPORTEVE TË PUNËS MËSIMORE DHE
KËRKIMORE-SHKENCORE TË UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS, PËR
VITIN AKADEMIK 2021-2022**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutin e UPT-së, Planin Strategjik 2019-2024 të UPT-së, Udhëzimin Nr. 5, datë 19.02.2018, “Për përcaktimin e elementëve përbërës të raportit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë”, Udhëzimi Nr. 24, datë 21.10.2019, Për një ndryshim në Udhëzimin Nr. 5, datë 19.02.2018, “Për përcaktimin e elementëve përbërës të raportit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë” Strategjinë Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin 2017-2022, Senati Akademik në mbledhjen e datës 06.03.2023,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportet e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore të Universitetit Politeknik të Tiranës, për vitin akademik 2021-2022.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Andrea Maligari



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA E KËRKIMIT SHKENCOR DHE PROJEKTEVE


Nr. 585/ Prot.
14

Tiranë, më 06/03 /2023

MIRATOHET

Kryetari i Senatit Akademik

Prof. Dr. Andrea MALIQARI



RAPORTI I AKTIVITETIT TË KËRKIMIT
SHKENCOR TË UNIVERSITETIT
POLITEKNIK TË TIRANËS PËR VITIN
AKADEMIK 2021-2022

Përgatitur nga Drejtoria e Kërkimit Shkencor dhe Projekteve

Drejtor i
Drejtorisë së Kërkimit Shkencor
dhe Projekteve
Prof. Dr. Aida Spahiu

Spahiu
2023

Rishikuar nga Zv. Rektori për anën
Shkencore

Prof. Asoc. Elfrida Shehu

Elfrida Shehu
2023

PËRMBAJTJA

I	INFORMACION MBI KËRKIMIN SHKENCOR NË UPT	6
I.1	Qëllimet dhe objektivat e kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovacionit	6
I.2	Strukturat përgjegjëse kërkimore	9
I.3	Politikat e Kërkimit Shkencore	10
II.	TË DHËNA MBI PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË “DOKTORATË”	12
II. 1	Programet e studimit të ciklit të tretë “Doktoratë”	12
II. 2	Lidhja dhe rëndësia e programeve të studimit të ciklit të tretë “Studime të Doktoratës” me nevojat e tregut të punës	14
III.	TË DHËNA MBI REALIZIMIN E KËRKIMIT SHKENCOR NË UPT	21
III.1	Burime të kërkimit shkencor	22
III.2	Fitimi i gradave shkencore dhe titujve akademikë	22
III.3	Botimet	28
III.4	Pjesëmarrja në aktivitete shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare si workshope, seminare, konferenca dhe kongrese	32
III.5	Pjesëmarrja në projekte kërkimore shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare	37
III.6	Pjesëmarrje si anëtar i bordit editorial në revista shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare	45
III.7	Çmime kombëtare/ndërkombëtare për punën kërkimore shkencore, patenta të regjistruara brenda ose jashtë Vendlindjes	48
III.8	Bashkëpunime me Sektorin e Prodhimit	48
III.9	Kontributi institucional	49
III.10	Aktivitete të tjera	49
III.11	Infrastruktura në shërbim të Kërkimit Shkencor	50
III.12	Biblioteka shkencore	58
III.13	Ndërkombëtarizimi në UPT	60
IV.	SHËRBIMET NDAJ TË TRETËVE	66
V.	AKTIVITETI I DREJTORISË SË KËRKIMIT SHKENCOR DHE PROJEKTEVE NË REKTORATIN E UPT-SË	68
VI.	ANALIZA E PUNËS KËRKIMORE SHKENCORE TË REALIZUAR GJATË VITIT AKADEMIK 2021-2022	93
VII.	SHTOJCA NR. 1: RAPORTET E PUNËS KËRKIMORE SHKENCORE TË NJËSIVE KRYESORE TË UPT-SË	95

Lista e Shkurtimeve

UPT- Universiteti Politeknik i Tiranës

FIN- Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit

FAU- Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës

FTI- Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit

FIM- Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike

FIMIF- Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike

FIE- Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike

FGJM- Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave

IGJEO- Instituti i Gjeoshkencave

Lista e tabelave

Tabela 1: Shpërndarja e udhëheqësve dhe kuotave sipas programeve të studimit të ciklit të tretë “Doktoratë”	13
Tabela 2: Gradat shkencore të fituara gjatë vitit akademik 2021-2022, sipas fakulteteve	24
Tabela 3: Shpërndarja e gradave shkencore dhe titujve akademikë për vitin akademik 2021-2022, sipas njësive kryesore	26
Tabela 4: Botimet e realizuara gjatë vitit akademik 2021-2022 sipas njësive kryesore	28
Tabela 5: Vlerësuesit e artikujve dhe numri i artikujve të vlerësuar	30
Tabela 6: Numri i botimeve si autor i parë/bashkë autor	30
Tabela 7: Pjesëmarrja e personelit akademik të njësive kryesore në aktivitete kombëtare	33
Tabela 8: Pjesëmarrja e personelit akademik të njësive kryesore në aktivitete ndërkombëtare	34
Tabela 9: Pjesëmarrja e personelit akademik në projekte kërkimore shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas njësive Kryesore	37
Tabela 10: Fushat kryesore të bashkëpunimit në projekte	39
Tabela 11: Aplikimet në kuadër të thirrjes së AKKSHI 2022 për projekte kombëtare të kërkimit dhe zhvillimit (PKZH)	40
Tabela 12: Aplikimet në kuadër të thirrjes së AKKSHI 2022 për projekte bilaterale me Turqinë (TUBITAK)	40
Tabela 13: Projektet fituese 2022 të aplikuara për thirrjen e "Projekte të Infrastrukturae së Kërkimit Shkencor (PKSH)"	42
Tabela 14: Lista e projekteve në proces	43
Tabela 15: Pjesëmarrje si anëtarë bordi editorial të personelit akademik sipas fakulteteve	45
Tabela 16: Krahasimi i shpërndarjes së personelit akademik që shërbejnë në borde editoriale të revistave shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas njësive kryesore, në dy vitet e fundit	47
Tabela 17: Bashkëpunime me sektorin e prodhimit sipas njësive kryesore	48
Tabela 18: Përfshirja e personelit akademik në aktivitete në mbështetje të Institucionit	49
Tabela 19: Aktivitete të tjera në të cilat është përfshirë personeli akademik në nivel Institucioni	49
Tabela 20: Laboratorët shkencorë sipas fakulteteve	50
Tabela 21: Numri total i titujve të rinj/sasia e tyre në cope për vitin 2021	59
Tabela 22: Numri total i titujve të rinj/sasia e tyre në cope për vitin 2022	59
Tabela 23: Numri i Stafit Outgoing sipas Universiteteve	62
Tabela 24: Numri të ardhur nga Universitete jashtë vendit në UPT, sipas Universiteteve, viti akademik 2021-2022	62
Tabela 25: Numri i studentëve Outgoing	64
Tabela 26: Numri i studentëve Incoming	65
Tabela 27: Numri i titujve akademike të dhënë nga KPPA	77

Lista e figurave

Figura 1: Shpërndarja e gradave të fituara sipas njësive kryesore	24
Figura 2: Shpërndarja e gradave të fituara sipas njësive dhe avancimit të personelit akademik të UPT-së	24
Figura 3: Krahasimi në dy vitet e fundit i fitimit të grades shkencore “Doktor” sipas njësive kryesore	25
Figura 4: Gradat dhe titujt akademik të fituara gjatë vitit akademik 2021-2022	26
Figura 5: Krahasimi në dy vitet e fundit i shpërndarjes së gradave shkencore dhe titujve akademikë sipas njësive kryesore	27
Figura 6: Krahasimi në dy vitet e fundit i shpërndarjes së gradave shkencore dhe titujve akademikë në nivel institucioni	27
Figura 7: Krahasimi në dy vitet e fundit i totalit të botimeve, sipas njësive kryesore	29
Figura 8: Vlerësuesit e artikujve dhe numri i artikujve të vlerësuar sipas njësive kryesore	30
Figura 9: Numri i botimeve si autor i parë/bashkë autor sipas njësive kryesore	31
Figura 10: Krahasimi i numrit të botimeve si autor i parë në dy vitet e fundit	31
Figura 11: Krahasimi i numrit të botimeve si bashkë autor në dy vitet e fundit	32
Figura 12: Krahasimi në dy vitet e fundit i pjesëmarrjes së personelit akademik të njësive kryesore në aktivitete kombëtare	33
Figura 13: Krahasimi i pjesëmarrjes së personelit akademik të njësive kryesore në aktivitete ndërkombëtare, në dy vitet e fundit	35
Figura 14: Shpërndarja e numrit të aktiviteteve kombëtare dhe ndërkombëtare sipas njësive kryesore	35
Figura 15: Krahasimi i pjesëmarrjes së personelit akademik të njësive kryesore në projekte, në dy vitet e fundit	38
Figura 16: Shpërndarja e projekteve, sipas llojit të projektit dhe njësive kryesore të UPT	38
Figura 17: Projektet e aplikuara Erasmus + 2022	44
Figura 18: Numri i personelit akademik që shërbejnë në borde editoriale të revistave shkencore	45
Figura 19: Shpërndarja e numrit të pjesëmarrësve në aktivitete të tjera sipas fakulteteve	50
Figura 20: Krahasimi i numrit të marrëveshjeve të bashkëpunimit në dy vitet e fundit	61
Figura 21: Mobilitetet Outgoing dhe Incoming të personelit akademik dhe administrativ sipas njësive kryesore	62
Figura 22: Krahasimi i numrit të mobiliteteve Outgoing dhe Incoming të personelit akademik dhe administrativ sipas njësive kryesore, në dy vitet e fundit	63
Figura 23: Mobilitetet Outgoing dhe Incoming të studentëve sipas njësive kryesore	64
Figura 24: Krahasimi i numrit të mobiliteteve Outgoing dhe Incoming të studentëve sipas njësive kryesore, në dy vitet e Fundit	65
Figura 25: Shpërndarja e titujve akademike të dhënë nga KPPA	77

I. INFORMACION MBI KËRKIMIN SHKENCOR NË UPT

Kuadri i përgjithshëm i punës kërkimore shkencore në Universitetin Politeknik të Tiranës gjatë periudhës raportuese është bazuar në Strategjinë Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin 2017-2022, në Statutin dhe Planin Strategjik 2019-2024 të Universitetit Politeknik të Tiranës. Ky aktivitet është në përputhje me misionin dhe principet e përgjithshme të kërkimit shkencor si dhe është bazuar në objektivat afatmesme të zhvillimit të kërkimit shkencor në UPT.

Veprimtaritë kërkimore dhe të zhvillimit në UPT lidhen me:

- a) punën krijuese të ndërmarrë mbi një bazë sistematike pranë njësisive bazë të UPT, në mënyrë që të rritet sasia dhe cilësia e dijeve;
- b) pjesëmarrjen në programe kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare, konferenca, seminare, kongrese, ëorkshop-e, etj;
- c) organizim i konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare, simpoziumeve dhe workshopeve në nivel njësie bazë dhe njësie kryesore.
- d) ç) publikimin e monografive dhe artikujve në periodikë apo seri botimesh shkencore me bord vlerësues dhe drejtues;
- e) pjesëmarrjen në borde revistash shkencore brenda dhe jashtë vendit, pjesmarrje si oponentë në këto revista;
- f) udhëheqjen e doktoratave, etj.

1. Qëllimet dhe objektivat e kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovacionit

Objektivat afatgjatë të zhvillimit të kërkimit shkencor në UPT bazohen në vizionin dhe misionin e UPT-së dhe në planin Strategjik të tij, ku përcaktohen objektivat strategjike të kërkimit shkencor:

1. Zhvillimi i burimeve njerëzore, i kapaciteteve infrastrukturore dhe financiare në shërbim të kërkimit shkencor dhe shërbimeve në UPT.

Për plotësimin e këtij objektivi është synuar:

- ruajtja dhe zhvillimi i burimeve njerëzore për të garantuar vazhdueshmërinë e kërkimit shkencor në UPT;
- rritja e fondeve për kërkimin shkencor dhe shërbimet në rang institucional si dhe miratimi i një

- buxheti të dedikuar për kërkimin shkencor në UPT të detajuar deri në nivel njësie bazë;
 - hartimin dhe zbatimin e një plani të detajuar për modernizimin e bibliotekave shkencore të fakulteteve për t'i kthyer në një burim të vlefshëm e të domosdoshëm informacioni në shërbim të kërkimit shkencor dhe zgjerimit të njohurive për studentët;
 - rekrutimi dhe krijimi i të gjitha mundësive për kërkuesit të rinj nëpërmjet hapjes së shkollave të doktoratës dhe trainimit të tyre në institucione të arsimit të lartë jashtë vendit, në shërbim të vazhdimësisë së zhvillimit të kërkimit shkencor në të ardhmen.
2. Rritja në sasi dhe cilësi e veprimtarisë kërkimore dhe e shërbimeve në mbështetje të prioriteteve strategjike të zhvillimit të vendit.

Për plotësimin e këtij objektivi është synuar:

- bashkëpunimi me institucionet publike dhe organizmat qeveritare me qëllim kontributin për trajtimin e problematikës, që lidhen me zhvillimin perspektiv të vendit për përballimin e sfidave në drejtim të një zhvillimi të qëndrueshëm;
- fuqizimi i kapaciteteve krijuese të personelit akademik e kërkimor të UPT nëpërmjet inkurajimit të lirisë kërkimore për të adresuar çështje me rëndësi shkencore në shërbim të zhvillimit të vendit;
- zhvillimi i kërkimit shkencor bazë dhe të zbatuar në gjithë fushat inxhinierike që mbulon UPT;
- zhvillimi i një klime bashkëpunimi me institucione të tjera publike dhe private brenda vendit që operojnë në fushat përkatëse inxhinierike;
- bashkëpunimi me sektorin privat për të mundësuar dhënien e ekspertizës dhe zgjidhjen e problemeve teknike e teknologjike që hasen;
- zhvillimi i kërkimit shkencor në UPT në përputhje me standartet e cilësisë.

Në këtë kuadër, me Vendim Nr. 01, datë 07.01.2022, “Për Akreditimin periodik të Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti Politeknik i Tiranës”, UPT mori Akreditimin Institucional me kohëzgjatje 6 (gjashtë) vite.

3. Rritja e kontributit të kërkimit shkencor në përmirësimin cilësor të ofertës akademike në të tre ciklet e studimit.

Për plotësimin e këtij objektivi është synuar:

- një thellim i integritetit të kërkimit shkencor me mësimdhënien, nëpërmjet angazhimit të studentëve të ciklit të dytë Master dhe ciklit të tretë Doktoratë në projekte studimore e kërkimore, me qëllim kultivimin tek këta të fundit të shprehive të kërkuesit e studjuesit të integruar në grup si dhe të ofrimit të kapaciteteve cilësore laboratorike dhe të vëzhgimit e eksperimentimit në terren;
- sigurimi dhe promovimi i lidhjeve të vazhdueshme me institucionet dhe universitetet homologe Evropiane dhe më gjerë përmes marrëveshjeve të qëndrueshme të bashkëpunimit dhe projekteve të përbashkëta në fushat me interes të përbashkët në shërbim të kualifikimit shkencor,

- doktoratave, postdoktoratave, dhe shkëmbimi i eksperiencave në këto fusha;
- përfshirja e studentëve në kërkimin shkencor, për të kontribuar në formimin e tyre profesional, rritjen e shkallës së përvetësimit të programeve mësimore, orientimin e tyre në tregun e punës, iniciimin e tyre si kërkues të ardhshëm si dhe për të realizuar objektivat e kërkimit.

4. Kthimi në prioritet bashkëpunimin dhe partneritetin në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar.

Për realizimin e ndërkombëtarizimit është synuar:

- Rritja e njohjes ndërkombëtare të titujve universitarë të lëshuar nga UPT, në të gjitha ciklet e studimit;
- Rritja e veprimtarisë ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor, nëpërmjet pjesëmarrjes në programet dhe projektet kërkimore kombëtare, evropiane, rajonale dhe më gjerë si anëtar dhe koordinator;
- Zgjerimi i bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e shkëmbimit të personelit akademik në mësimdhënie dhe trainime;
- Intensifikimi i shkëmbimeve ndërkombëtare të studentëve në kornizën e programeve ndërkombëtare dhe marrëveshjeve dypalëshe;
- Promovimi i formimeve dhe diplomave të përbashkëta apo të dyfishta me institucione homologe ndërkombëtare, kryesisht të ciklit të dytë dhe të tretë, duke i dhënë në këtë mënyrë një vlerë të shtuar formimit dhe titujve universitarë në të tre ciklet e studimit, të ofruar nga UPT.

Politikat e bashkëpunimit janë konceptuar si në plan të brendshëm e kombëtar: në nivel institucioni dhe brenda vendit; ashtu edhe në plan ndërkombëtar: rajonal, evropian dhe më gjerë. Si aktorë në nivel institucioni, parashikohen anëtarët e stafeve akademike dhe ndihmës akademike, si dhe studentët, në veçanti ata të ciklit të dytë dhe të tretë të studimeve.

Politikat e bashkëpunimit të brendshëm dhe të jashtëm, si dhe ato të ndërkombëtarizimit të UPT, hartohen, diskutohen, mbështeten, miratohen dhe raportohen nga organet e të gjitha niveleve të këtij institucioni, duke filluar nga Rektorati, Senati, Bordi i Administrimit e deri te dekanatet/drejtoria e Institutit dhe departamentet, si njësi bazë e veprimtarisë.

5. Rritja dhe forcimi i rolit të Institutit të Gjeoshkencave (IGJEO) në kërkimin shkencor, si njësi kryesore kërkimore e ekselencës në fushat përkatëse të ekspertizës.

Për plotësimin e këtij objekti është synuar:

- mbështetja për realizimin e një projekti Evropian për strategjinë e zhvillimit të Institutit në bashkëpunim dhe partneritet me institucionet homologe;
- forcimi i një bashkëpunimi të qëndrueshëm me njësitë e tjera kryesore të UPT me pjesëmarrjen

e personelit akademik në kërkimin shkencor dhe, anasjelltas, të punonjësve kërkimorë në mësimdhënie;

- integrimi i praktikave mësimore dhe profesionale të studentëve në veprimtarinë e institutit;
- zhvillim i qendrueshëm i karrierës dhe shkëmbimi i praktikave më të mira në institucionet partnere dhe më gjerë dhe transmetimi i atyre përvojave në mësimdhënie.

6. Rritja e kontributit të kërkimit shkencor, veprimtarive krijuese dhe ekspertizës në fushat përkatëse inxhinierike në sigurimin e të ardhurave nga puna për të tretët për UPT.

Për plotësimin e këtij objektivi është synuar:

- pjesëmarrje aktive në projektet e financuara nga AKKSHI;
- krijimi i të ardhurave nga veprimtaritë kërkimore-shkencore, nga të drejtat intelektuale, nga markat dhe patentat, nga shërbimet, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- një pjesëmarrje më e gjerë në ekspertiza e konsulencë, duke i konsideruar si elementë jo vetëm të afirmimit profesional e shkencor.

Objektivat afatmesme dhe afatshkurtra janë rrjedhim, detajim dhe zbërthim i objektivave strategjike të UPT-së, në fushën e kërkimit shkencor. Ato synojnë një zhvillim më të qendrueshëm në këtë fushë dhe zhvillimin e burimeve njerëzore, kapaciteteve infrastrukturore dhe financiare, në shërbim të kërkimit shkencor.

Objektivat afatmesme dhe afatshkurtra fokusohen në fushën e promovimeve akademike dhe shkencore, në fushën e kërkimit shkencor, ekspertizave, konsulencave dhe projekteve si dhe në fushën e botimeve shkencore.

Rezultatet e veprimtarisë kërkimore shkencore në UPT në përputhje me objektivat strategjike, sipas njësive kryesore përbërëse të tij, dhe sipas aktiviteteve të ndryshme të kërkimit shkencore, janë paraqitur në raportimet e njësive kryesore të UPT-së, Kapitulli VII “Shtojca Nr.1: Raportet e Punës Kërkimore Shkencore të Njësive Kryesore të UPT-së”.

2. Strukturat përgjegjëse kërkimore

Veprimtaria kërkimore-shkencore në UPT zhvillohet në:

- njësitë bazë të Fakulteteve;
- njësitë bazë të Institutit të Kërkim-Zhvillimit (IGJEO).

Departamentet në UPT, kanë të drejtë të organizohet në grupe kërkimore-shkencore, të përhershme ose të përkohëshme.

Në strukturën akademike të UPT, Instituti (IGJEO) funksionon si njësi kryesore dhe departamentet si njësi bazë. Instituti (IGJEO) në UPT kryen veprimtari kërkimore-shkencore dhe zhvillimi, si edhe

merr pjesë në realizimin e programeve të studimit në të gjitha ciklet e studimit, që ofrohen nga UPT.

Njësitë bazë të Fakultetit dhe të Institutit të kërkim-zhvillimit (IGJEO) në UPT:

- zhvillojnë veprimtaritë e tyre në përputhje me misionin dhe fushat prioritare të kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit, si edhe me programet e zhvillimit në rang rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar;
- iu nënshtrohen kritereve të financimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore, të përcaktuara në statutin e UPT dhe në kornizën ligjore në fuqi;
- kanë detyrimin të bëjnë publike veprimtarinë e tyre, si dhe rezultatet përkatëse, me përjashtim të rasteve të veçanta, që rregullohen në kornizën ligjore.

Veprimtaria kërkimore-shkencore e krijuese, planifikohet, zbatohet, monitorohet dhe raportohet në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, me planin strategjik të UPT-së, me Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës si dhe me rregullore e vendime të ndryshme në përputhje me fushën e veprimtarisë.

Veprimtaria kërkimore-shkencore në UPT realizohet mbi bazën e programeve dhe projekteve të miratuara dhe të realizuara në njësitë bazë, njësitë kryesore dhe struktura ndërdisiplinore.

Fushat kërkimore dhe drejtimet kryesore të veprimtarisë kërkimore, përcaktohen mbi bazën e propozimeve të njësisë bazë dhe kryesore të tij si dhe miratohen nga SAUPT.

UPT harton/realizon programe dhe projekte kërkimore në bashkëpunim me institucione të tjera publike ose private, brenda dhe jashtë vendit.

3. Politikat e Kërkimit Shkencor

Politikat e kërkimit shkencor janë me rëndësi të veçantë në të gjithë veprimtarinë e UPT, duke shprehur dhe konkretizuar lirinë akademike, të drejtën për të publikuar dhe përhapur kontribute dhe të drejtën e shprehjes së mendimit.

Kërkimi shkencor në UPT mbështetet në prioritetet strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit dhe gërshetohet me mësimdhënien, me pikësynim rritjen e cilësisë së ofertës akademike.

UPT promovon kërkimin shkencor bazë dhe të zbatuar. Ai siguron koordinimin dhe zhvillimin e projekteve kërkimore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. UPT nxit përfundimin e njohurive më të përparuara shkencore dhe teknologjike dhe u jep vlerë ekspertizës dhe aftësive kërkimore të tij në fusha të ndryshme të shkencës dhe kërkimit. Kërkimi shkencor në UPT është veprimtari me interes të gjerë publik, që ndërmerret për të përmbushur misionin e njësisë bazë të tij, sipas standardeve bashkëkohore.

UPT synon dhe ka arritur rezultate në drejtim të zhvillimit të burimeve njerëzore për të garantuar

vazhdueshmërinë e kërkimit shkencor; të rritjes së fondeve për kërkimin shkencor dhe shërbimet në rang institucional; të përmirësimit të infrastrukturës së kërkimit shkencor; të modernizimit të bibliotekave shkencore të fakulteteve, për t'i kthyer në një burim të vlefshëm e të domosdoshëm informacioni në shërbim të kërkimit shkencor dhe zgjerimit të njohurive për studentët, etj.

Në UPT, rritja në sasi dhe cilësi e veprimtarisë kërkimore shkencore është një pikë e fortë dhe praktikë e mirë. Për këtë është synuar dhe janë arritur rezultate të mirë në drejtim të bashkëpunimit me institucionet publike dhe organizmat qeveritare; të fuqizimit të kapaciteteve krijuese të personelit akademik e kërkimor; të zhvillimit të kërkimit shkencor bazë dhe të zbatuar në gjithë fushat inxhinierike që mbulon UPT; të bashkëpunimit me sektorin privat për të mundësuar dhënien e ekspertizës dhe zgjidhjen e probleme teknike e teknologjike që hasen; të zhvillimit të kërkimit shkencor në UPT në përputhje me standartet e cilësisë.

UPT, për përmbushjen e objektivit të tij për rritjen e kontributit shkencor në përmirësimin cilësor të ofertës akademike, në të tre ciklet e studimit, ka mundur të realizojë, veçanërisht gjatë viteve të fundit:

- një thellim të integritit të kërkimit shkencor me mësimdhënien, nëpërmjet angazhimit të studentëve të nivelit Master dhe Doktoratë në projekte studimore e kërkimore, me qëllim kultivimin të këta të fundit të shprehive të kërkuesit e studjuesit të integruar në grup, etj;
- sigurimin dhe promovimin e lidhjeve të vazhdueshme me institucionet dhe universitetet homologe evropiane dhe më gjerë, përmes marrëveshjeve të qëndrueshme të bashkëpunimit dhe projekteve të përbashkëta në fushat me interes të përbashkët në shërbim të kualifikimit shkencor, doktoratave, postdoktoratave dhe shkëmbimin e eksperiencave në këto fusha;
- përfshirjen e studentëve në kërkimin shkencor, për të kontribuar në formimin e tyre profesional, rritjen e shkallës së përvetësimit të programeve mësimore, orientimin e tyre në tregun e punës, iniciimin e tyre si kërkues të ardhshëm, si dhe për të realizuar objektivat e kërkimit.

Rritja e veprimtarisë ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor, nëpërmjet pjesëmarrjes në programet dhe projektet kërkimore kombëtare, evropiane dhe rajonale dhe më gjerë, është një pikë e fortë e UPT në përmbushjen e politikave të tij mbi kërkimin shkencor.

UPT ka konsoliduar një praktikë të mirë për evidentimin dhe përhapjen e rezultateve të kërkimit shkencor bazë dhe të zbatuar. Në këtë drejtim është arritur:

- një administrim më i mirë i kërkimit shkencor, nëpërmjet krijimit të bazave të të dhënave dixhitale, lehtësisht të përdorshme, si dhe inventarizim më të mirë të pasurive shkencore të UPT;
- bërja publike e të gjithë projekteve të financuara, në kuadrin e programeve kombëtare dhe ndërkombëtare të kërkim-zhvillimit, për një shfrytëzim sa më të gjerë të informacionit shkencor;
- publikimi i rezultateve të kërkimit shkencor në revista të njohura, si brenda ashtu edhe jashtë vendit.

II. TË DHËNA MBI PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË “DOKTORATË”

1. Programet e studimit të ciklit të tretë “Doktoratë”

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave, Nr. 112, datë 23.02.2018 “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “profesor i asociuar” dhe “profesor” i ndryshuar, Udhëzimin Nr. 1, datë 14.1.2020 dhe Udhëzimin Nr. 7, datë 31.3.2021, për “Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e Institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë”, Rregulloren e Studimeve të Doktoratës në Universitetin Politeknik të Tiranës, Neni 5, si dhe në zbatim të Urdhërave të MAS për hapjen e programit të studimit, Nr. 175, Nr. 176, Nr. 177, Nr. 178, Nr. 179, Nr. 180, Nr. 181, Nr. 182, Nr. 183, datë 4.4.2022, UPT, gjatë vitit akademik 2021-2022, ka realizuar hapjen e pranimeve në studimet e ciklit të tretë “Doktoratë” në Universitetin Politeknik të Tiranës në programet e studimit si më poshtë:

1. Doktoratë në “Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit”, nënfusha “Inxhinieri Informatike” dhe nënfusha “Telekomunikacion dhe Inxhinieri Informacioni” - Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit,
2. Doktoratë në “Inxhinieri Fizike” - Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike
3. Doktoratë në “Inxhinieri Elektrike”, nënfusha “Automatizimi i Industrisë” - Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike,
4. Doktoratë në “Inxhinieri Elektrike”, nënfusha “Energjistikë” - Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike,
5. Doktoratë në “Inxhinieri Ndërtimi”, nënfusha “Inxhinieri Mjedisi” – Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit,
6. Doktoratë në “Gjeodezi” - Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit
7. Doktoratë në “Gjeologjia dhe Mjedisi” - Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave,
8. Doktoratë në “Inxhinieri Naftë dhe Gazi” - Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave,
9. Doktoratë në “Konstruksione mekanike dhe vlerësimi i integritetit strukturor” – Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike.

Në këtë kuadër, është kryer puna përgatitore për hapjen e programeve të mësipërme, përcaktimin e kriterëve të përgjithshme për aplikim, shpalljen e thirrjes për hapjen e pranimeve në studimet e doktoratës, etj.

Njësitë bazë përgjegjëse për studimet e doktoratës ngritën komisionet “Ad-hoc”, të cilët, kryen vlerësimin dhe renditjen paraprake të kandidatëve, mbështetur në dosjet e aplikimit.

Këshillat e Profesorëve pranë çdo njësie kryesore, pas shqyrtimit të dosjeve të çdo kandidati, mbështetur në raportet e vlerësimit si dhe në gjykimin e anëtarëve të tij shpallën dhe publikuan kandidatët fitues në faqen zyrtare të njësisë kryesore përkatëse si dhe në ambientet e saj.

Tabela 1: Shpërndarja e udhëheqësve dhe kuotave sipas programeve të studimit të ciklit të tretë “Doktoratë”

FAKULTETI	EMERTIMI I PROGRAMIT	NUMRI I UDHEHEQESVE MIRATUAR NGA MAS	NUMRI I UDHEHEQESVE MIRATUAR NGA FAKULTETI	TOTALI KUOTA PER CIKEL
Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit	Doktoratë në “Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit”, nënfusha “Inxhinieri Informatike” dhe nënfusha “Telekomunikacion dhe Inxhinieri Informacioni”	14	12	34
Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike	Doktoratë në “Inxhinieri Fizike”	1	1	2
Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike	- Doktoratë në “Inxhinieri Elektrike”, nënfusha “Automatizimi i Industrisë” - Doktoratë në “Inxhinieri Elektrike”, nënfusha “Energjitikë”	2 2	2 2	10 5
Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit	- Doktoratë në “Inxhinieri Ndërtimi”, nënfusha “Inxhinieri Mjedisi” - Doktoratë në “Gjeodezi”	6 3	3 2	6 6
Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave	- Doktoratë në “Gjeologjia dhe Mjedisi” - Doktoratë në “Inxhinieri Naftë dhe Gazi”	3 6	2 6	10 10
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	Doktoratë në “Konstruksione mekanike dhe vlerësimi i integritetit strukturor”	3	1	10

Gjithashtu, gjatë vitit akademik 2021-2022, Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës ka hartuar, organizuar dhe aplikuar për hapjen e programit të përbashkët të studimit të ciklit të tretë, Doktoratë në

“Qëndrueshmëria dhe Inovacioni për projektin e mjedisit të ndërtuar dhe sistemit të produktit”, me nënfusha “Dizajn”, “Teknologji Arkitekture”, “Planifikim Urban dhe Territorial”, “Arkitekturë Peisazhi”, në Universitetin Politeknik të Tiranës me Departamentin e Arkitekturës (DIDA) të Universita degli Studi di Firenze (UNIFI).

Ky program do të zhvillohet në gjuhën shqipe, italiane dhe angleze dhe në përfundim të tij do të lëshohet diploma e dyfishtë e e ciklit të tretë “Doktor” në “Qëndrueshmëria dhe Inovacioni për projektin e mjedisit të ndërtuar dhe sistemit të produktit”, me nënfusha “Dizajn”, “Teknologji Arkitekture”, “Planifikim Urban dhe Territorial”, “Arkitekturë Peisazhi”, në Universitetin Politeknik të Tiranës dhe në Fakultetin e Arkitekturës të Universitetit të Firences, referuar nivelit 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

2. Lidhja dhe rëndësia e programeve të studimit të ciklit të tretë “Studime të Doktoratës” me nevojat e tregut të punës

Të gjitha programet e studimit të ciklit të tretë “Studime të Doktoratës” në UPT, ofrohet në përputhje me misionin dhe qëllimet e Institucionit dhe strategjinë e tij për zhvillim.

Këto programe, përfshijnë fusha që përbëjnë prioritet kombëtar, sipas përcaktimeve në dokumentin e prioritetëve të miratuar nga MAS, me Vendimin Nr. 386, datë 1.6.2022, “Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer dhe studentëve që ndjekin këto programe në institucionet e arsimit të lartë”, të tilla si: Inxhinieri Mjedisi, Inxhinieri e Burimeve Minerare, Inxhinieri e Naftës dhe Gazit, Inxhinieri Gjeologjike, Inxhinieri Gjeomjedisi, etj.

Gjithashtu, këto programe, janë bazuar në fushat e miratuara nga Senati Akademik i UPT-së me Vendimin Nr. 5, datë 29.09.2020, “Për miratimin e fushave të kërkimit shkencor të Universitetit Politeknik të Tiranës”.

- Doktoratë në “Inxhinieri Fizike”

Analiza e kërkesës së tregut të punës për këtë program studimit konsiston në studimin e ecurisë në këtë fushë në botë, nga studimet dhe analizat e zhvillimit në vend si edhe parashikimi i kërkesës për të ardhmen.

Ofrimi i njohurive të thelluara, gjithëpërfshirëse dhe komplekse mund të realizohen nëpërmjet ofrimit të programit të ciklit të tretë, studime të doktoratës në Inxhinieri Fizike, nga Departamenti i Inxhinierisë fizike në FIMIF, UPT.

Disa të dhëna të dobishme mbi nevojën e hapjes së studimeve të Doktoratës në fushën e Inxhinierisë dhe teknologjisë, Vendim Nr. 710, datë 1.12.2017;

<http://www.qbz.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202017/Fletore%202015/VKM%20nr.%20>

710,%20date%201.12.2017.pdf, tregojnë gjendjen aktuale në të cilën ndodhet kërkimi shkencor në Shqipëri. Kërkues shkencor në këto fusha janë vetëm 12.3%, gjë që thekson nevojën për riorganizimin e studimeve të doktoratës në Inxhinieri Fizike, në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike të Universitetit Politeknik të Tiranës.

Në të dhënat e marra nga ‘Strategjia kombëtare për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin, 2017-2022’ vërehet se pjesa më e madhe e stafit është e përqëndruar në shkencat sociale, ndërkohë që përqindja e stafit e angazhuar në shkencat inxhinierike dhe teknologjike është mjaft e ulët, vetëm 12.3%. Si pasojë, lind nevoja e kualifikimit të mëtijshëm të studentëve, të cilët pasi mbarojnë diplomën e ciklit të dytë “Master i Shkencave” dhe mund të regjistrohen në studimet e doktoratës, si pasojë e kërkesës së tregut për staf të kualifikuar në fushat inxhinierike. Rreth 59% e stafit akademik të këtyre institucioneve kanë kryer studimet e doktoraturës, ndërkohë që 41% nuk e kanë nisur akoma. Kjo përqindje e madhe, e stafit të pakualifikuar nxit nevojën e hapjes së programeve ciklit të tretë, studime të doktoraturës në vend. Si pasojë e kalimit të shumë viteve që nga miratimi i kuotave të fundit për vazhdimin e programit të doktoraturës, lind domosdoshmëria e riorganizimit së këtyre programeve të ciklit të tretë. Në këtë mënyrë mund të kualifikohet stafi akademik i vetë Universitetit Politeknik të Tiranës, por jo vetëm. Ndërkohë përqindja e stafit akademik me doktoraturë në universitetet private është vetëm 20%.

Mundësitë e punësimit mbas mbarimit të këtij programi studimi, në drejtim të fushave kërkimore ku mbështet ky propozim janë të shumta si në: mjedisin akademik universitet, kompani të ndryshme industriale, farmaceutike dhe mjeksore me teknologji të përparuar, etj.

- **Doktoratë në “Inxhinieri Elektrike”, në fusha “Automatizimi i Industrisë”**

Analiza e kërkesës së tregut të punës konsiston në studimin e ecurisë në këtë fushë në botë, nga studimet dhe analizat e zhvillimit në vend si edhe parashikimi i kërkesës për të ardhmen. Raporti i OECD i vitit 2020 prashikon përqindja e të rinjve që ndjekin studimet doktorale është dyfishuar në krahasim me dy dhjetvjeçarë më parë. Kjo kërkesë në rritje vjen së pari, si përgjigje ndaj ndryshimit të tregut të punës, në të cilin mendohet senë vitet në vazhdim, 25% e vendeve të lira të punës do të jenë profesione të reja të cilat nuk kanë ekzistuar më përpara. (https://www.oecd-ilibrary.org/education/education-at-a-glance-2020_69096873-en).

Sipas të dhënave zyrtare statistikore mundësitë e punësimit për individët që kanë përfunduar studimet e doktoraturës janë më të larta. Për vitin 2018, rreth 22.5% e të papunëve janë më arsim të lartë, ndërsa 0.2% e tyre janë me doktoraturë (INSTAT 2019). Statistikat e vitit 2017 nga INSTAT tregojnë për një administratë publike me rreth 164 mijë individë të punësuar (ose 17,7%) ndërsa në kompanitë private të regjistruar në sektorin industrial ofrojnë rreth 320 mijë vende pune (ose 34.4%). (“Tregu i punës” INSTAT <http://ëëë.instat.gov.al/media/5575/tregu-ipunes-2018-ang-alb.pdf>).

Raporti “E ardhmja e vendeve të Punës, Punësimit, Aftësive dhe Forcës të Punës”, botuar në janar 2016 dhe i paraqitur në Forumin Botëror të Ekonomisë, argumenton se, deri në 2020, tregu do të humbasë rreth 5 milionë vende pune, rrjedhojë e “Revolucionit të Katërt Industrial”. I njëjti raport

konfirmon se 65% e fëmijëve, që u regjistruan në shkollë në dy vitet e fundit, do të punojnë në vende pune, të cilat sot nuk njihen ende. (The Future of Jobs Employment, Skills and 20 Workforce Strategy for the Fourth Industrial Revolution, WEF, January 2016: http://www.weforum.org/docs/WEF_Future_of_Jobs.pdf)

Revolucioni i Katërt Industrial (ose Industria 4.0) është automatizimi i vazhdueshëm i prodhimit tradicional dhe praktikave industriale, duke përdorur teknologjinë moderne inteligjente. Komunikimi në shkallë të gjerë makinë me makinë (M2M) dhe interneti i gjërave (IoT) janë të integruara për rritjen e automatizimit, përmirësimin e komunikimit dhe vetë-monitorimin, dhe prodhimin e makinave inteligjente që mund të analizojnë dhe diagnostikojnë çështje pa nevojën e ndërhyrjes njerëzore. (<https://www.weforum.org/about/the-fourth-industrial-revolution-by-klausschwab>).

Biznesi vendas është duke investuar në teknologjitë e reja kryesisht nëpërmjet procesit të digjitalizimit dhe inovacionit të aplikuar në proceset industriale. Qeveria dhe institucionet e tjera publike po hartojnë programe dhe po ndërmarrin veprime konkrete për të inkurajuar përfaqshën e biznesit drejt përdorimit të këtyre teknologjive të reja. Shkolla e studimeve të doktoratës në Inxhinieri Elektrike, nënfisha “Automatizimi i Industrisë” do të sigurojë ofrimin e njohurive të thelluara, gjithëpërfshirëse dhe komplekse.

- Doktoratë në “Inxhinieri Elektrike”, nënfisha “Energjistikë”

Rihapja e ciklit të tretë të studimeve në Inxhinieri Elektrike, nënfisha Energjetike, është i rëndësishëm për universitetin në veçanti, por edhe për vendin në përgjithësi, pasi gjithnjë e më shumë po vërehet një mungesë drastike e stafit të kualifikuar në këtë fushë. Nëpërmjet rihapjes së këtij programi, FIE synon të përgatisë kërkues shkencorë të zotë, persona me aftësi analitike për të zgjidhur problemet dhe optimizuar proceset në industri dhe kërkim shkencor.

Gjendja aktuale në të cilën ndodhet kërkimi shkencor në Shqipëri, tregon se, kërkues shkencor në fushat e Inxhinierisë dhe Teknologjisë janë vetëm 12.3%, gjë që thekson nevojën për hapjen e këtij programi.

Me aftësitë e fituara gjatë viteve akademike, studentët do të kenë mundësi të punësohen në institucione publike apo private, ku kërkesa për specialistë është mjaft e lartë.

Një doktorant në Inxhinieri Elektrike, gjatë zhvillimit të studimeve të doktoratës fiton gjithë aftësitë dhe dijet e nevojshme për të projektuar dhe zhvilluar kërkime shkencore. Ato, përveçse japin kontributin e tyre në jetën akademike, ndihmojnë edhe në zhvillimin e sektorit të industrisë, me ide inovative dhe risi që do të zhvillojnë tregun shqiptar.

Me rritjen e nevojës për ekspertizë teknike, ky program mund të bëhet një pikë kyçe për punësim. Në fund të programit, doktoranti pritët të punojë në sektorë të ndryshëm si: kërkues shkencor në laboratorë të universiteteve apo kompanive, lektor në universitete brenda apo jashtë vendit, inxhinier projektimi si edhe inxhinier në institucione të ndryshme.

- Doktoratë në “Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit”, nënfusha “Inxhinieri Informatike” dhe nënfusha “Telekomunikacion dhe Inxhinieri Informacioni”

Biznesi vendas është duke investuar në teknologjitë e reja kryesisht nëpërmjet procesit të diditalizimit dhe inovacionit. Qeveria dhe institucionet e tjera publike po hartojnë programe dhe po ndërmarrin veprime konkrete për të inkurajuar përfaqshën e biznesit drejt përdorimit të këtyre teknologjive të reja.

Sipas të dhënave zyrtare të INSTAT [Burimi: <http://www.instat.gov.al/al/temat/tregu/-i-pun%C3%ABs-dhe-arsimi/arsimi/#tab2>] vërehet se në vitin akademik 2019-2020, niveli i studentëve të regjistruar në programet e ciklit të dytë Mastër në Fakultetet e Teknologjisë së Informacionit është i lartë. Ndër to, një pjesë e mirë e studentëve të diplomuar në Mastër, janë të interesuar të zhvillojnë studime të mëtejshme në ciklin e tretë të studimeve.

Sipas të dhënave të publikuar nga RASH, [Burimi: <https://kerkimi-shkencor.arsimi.gov.al/Statistika/Detajet/30>] rreth 59,5% stafit akademik kanë kryer studimet Phd. Doktor Shkencash, 40.5% e tyre nuk kanë kryer studime Phd/Doktor Shkencash. Në Fletoren Zyrtare Nr. 215 Vendimi Nr. 710, datë 01.12.2017 i Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Strategjive Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin, 2017-2022”.

Kjo strategji dhe plani i saj i veprimt synon në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së kapaciteteve njerëzore në fushën e shkencës, zhvillimit të teknologjisë dhe inovacionit. Kjo strategji ka përcaktuar aktivitete të rëndësishme që shtrihen përgjatë periudhës 2017-2022 duke synuar forcimin dhe zhvillimin afatgjatë e të qëndrueshëm të strukturave institucionale të kërkimit shkencor në universitetet dhe institucione të tjera të kërkimit.

- Doktoratë në “Inxhinieri Ndërtimi”, nënfusha “Inxhinieri Mjedisit”

Analiza e kërkesës së tregut të punës konsiston në studimin e ecurisë në këtë fushë në botë, nga studimet dhe analizat e zhvillimit në vend si edhe parashikimi i kërkesës për të ardhmen.

Sipas Byrosë Amerikane të Statistikave të Punës, vetëm për profesionistët e mjedisit dhe ujit me nivelin Bachelor, punësimi pritet të rritet me 13% brenda 10 viteve të fundit.

<https://www.bls.gov/ooh/life-physical-and-social-science/hydrologists.htm#:~:text=Employment of hydrologists is projected to increase demand for hydrologists>

Zhvillimi i ndërtimeve, industrive të llojeve të ndryshme dhe problematikat mjedisore si cilësia e mjedisit, përmytjet dhe thatësira të shkaktuara nga ndryshimet klimatike, priten të përkthehen në rritjen e kërkesës për profesionistë mjedisorë, të cilët mund t'i adresojnë këto problematika.

Biznesi vendas është duke investuar në fushën e ndërtimeve ndaj dhe ndërtimi në formë të sigurtë duke pasur parasysh zhvillimin e integruar të zonave urbane, e bën fushën e Inxhinierisë së Mjedisit dhe Menaxhimit të Burimeve Ujore thelbësore dhe me rëndësi të veçantë, si për biznesin ashtu edhe për qeverinë. Në veçanti, theksojmë zhvillimin dhe planifikimin e territorit si dhe hartimin e strategjive kombëtare të përditësuara për ujin sipas Direktivave Europiane.

Në përfundim sa më lart, ofrimi i njohurive të thelluara, gjithëpërfshirëse dhe komplekse mund të ofrohet nëpërmjet programit të studimeve të doktoratës të ofruar nga Departamentit të Inxhinierisë së Mjedisit, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit.

- Doktoratë në “Gjeodezi”

Analiza e kërkesës së tregut të punës për këtë program studimi, konsiston në studimin e ecures në këtë fushë në botë, nga studimet dhe analizat e zhvillimi të kësaj fushe në vendin tonë si dhe nga parashikimi i kërkesës për këtë profesion në të ardhmen.

Sipas të dhënave zyrtare statistikore, mundësitë e punësimit për individët që kanë përfunduar studimet e doktoratës janë më të larta. Për vitin 2018, rreth 22.5% e të papunëve janë me arsim të lartë, ndërsa 0.2% e tyre janë me doktoratë (INSTAT 2019).

Biznesi vendas dhe instancat shtetërore janë duke investuar në fushën e planifikimeve dhe të ndërtimeve sipas parimit të zhvillimit të qëndrueshëm. Duke patur parasysh, zhvillimin e teknologjisë për mbledhjen e informacionit gjeohapësinor, për realizimin e matjeve dhe hartografimin e realitetit në formë më të detajuar, i jepet rëndësi e veçantë qasjes dhe përdorimit të këtyre informacioneve në mënyrë masive.

Për sa më lart, ofrimi i njohurive më të thelluara, gjithëpërfshirëse dhe komplekse, mund të mundësohet nëpërmjet këtij programi studimi të ciklit të tretë.

- Doktoratë në “Gjeologjia dhe Mjedis”

Fakulteti i Gjeologjisë dhe departamentet e tij, përfshirë Departamentin e Shkencave të Tokës, janë të vetmit në rang vendi, dhe për rrjedhojë, Programi i Ciklit i III-të i studimeve “Doktoratë” në “Gjeologjia dhe Mjedis” është program unik në rang vendi dhe nuk ofrohet nga ndonjë IAL tjetër. Në kuadrin e këtij programi do të kryhen studime të thelluara dhe kërkime shkencore në Gjeologji dhe Mjedis, dhe më hollësisht në: gjeologjinë regjionale, tektonikë, gjeologji strukturore, stratigrafi, paleontologji, petrologji, mineralogji, gjeokimi, sedimentologji dhe gjeofizikë dhe në shkencat e gjeomjedisit.

Specialistët e doktoruar në Gjeologji dhe Mjedis kanë mundësi punësimi në tregun vendas të punës, publik dhe privat. Në tregun publik të punës përfshihen Fakulteti i Gjeologjisë

dhe Minierave (FGJM), Instituti i Gjeoshkencave, Ujit, Energjise dhe Mjedisit IGJEUM), Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH), Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), Ministrinë e linjës, Bashkitë. Profesionistë të kualifikuar (doktoruar) kërkohen edhe nga tregu privat, në veçanti nga kompanitë e mëdha të huaja që operojnë në kërkimshfrytëzimin e vendburimeve të mineraleve të dobishëm dhe vendburimeve hidrokarbure, programe dhe projekte europiane në fushën e Mjedisit.

Mungesa për një periudhë të gjatë e specializimeve pas-universitare ka krijuar një boshllëk në institucionet kërkimore-teknike për specialistë. Shkolla e doktoraturës në Gjeologji dhe Mjedis që Departamenti i Shkencave të Tokës ofron në kuadrin e këtij programi, do të tentojë të plotësojë këtë vakum të krijuar. Realizimi i doktoraturave në drejtimet e ngushta të treguara në paragrafin (a) do të përgatisë jo vetëm profesionistë të doktoruar por edhe specialistë në fushat përkatëse ku do zhvillojnë doktoraturat. Departamenti i Shkencave të Tokës, si i vetmi në rang vendi, që nxjerr specialistë të diplomuar në Gjeologji dhe Mjedis, nëpërmjet ciklit të tretë të studimeve të Doktoraturës, do të krijojë profesionistë të rinj të kualifikuar dhe profilizuar në fushat e mësipërme.

Lidhja e studentëve të doktoraturës me tregun e punës do të realizohet së pari nëpërmjet promovimit të rezultateve të kërkimit shkencor të doktorantëve nga ana e Departamentit të Shkencave të Tokës (FGJM-UPT). Kjo arrihet përmes postimit të botimeve të artikujve të ndryshëm në revista shkencore brenda dhe jashtë vendit nga ana e doktorantëve, nëpërmjet pjesëmarrjes në konferenca shkencore për prezantimin e rezultateve të arritura dhe sidomos, përmes marrëveshjeve apo memorandumeve midis DSHT-FGJM me institucione publike dhe subjekte private, të cilat u japin mundësi doktorantëve të prezantojnë arritjet e tyre kërkimore që mund të zgjojnë interesin e institucioneve apo subjekteve pritëse.

- Doktoratë në “Inxhinieri Naftë dhe Gazi”

Përvoja e deritanishme e studentëve që kanë përfunduar studimet në fushën e industrisë së naftës (për të dy ciklet e studimeve si edhe për DIND), tregon që ata janë punësuar dhe kanë paraqitur nivel të mirë në zgjidhjen e detyrave profesionale. Studentët e Programit të studimeve të ciklit të tretë – Doktoratë në Inxhinieri Naftë dhe Gazi, pajisen me njohuri që duhen për zbatim në fusha të tilla të rëndësishme të ekonomisë si industria e naftës, projektimit të puseve të shpimit, projektimit të lëngjeve larës, ligjësi të filtrimit të fluideve jo Njutonianë, teknologjitë e informacionit, projektet infrastrukturore, modelimi numerik, metodave të llogaritjes së rezervave, MVSH etj.

Ato do të përbëjnë një kontigjent të kërkuar nga tregu i punës. Përfundimi i ciklit të studimeve të tretë “Doktoratë” në Inxhinieri Naftë dhe Gazi, u krijon të diplomuarve shanse për t’u punësuar në fushat e mëposhtme të aktivitetit ekonomik e administrativë:

- Shoqëritë private të sektorëve industrial dhe institucioneve kërkimore-shkencorë;

- Universiteti Politeknik të Tiranës;
- Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore;
- Institucionet lokale dhe qendrore të cilat merren me sektorët industrial;
- Institucionet dhe kompanitë private të industrisë së naftës, gazit dhe ujit;
- Prefekturat, bashkitë dhe qarqet për problemet e lidhura me industrinë, me përparësi sektorin e Hidrokarburëve.

Në ndihmë të studentëve të SC3SHDING dhe të Sektorit të Naftës dhe Gazit në Shqipëri do të vijnë:

- Marrëveshja e Bashkëpunimit Akademik, në Fushën Inxhinierike dhe atë të Kërkimit Shkencor, midis UPT (nënshkruar në datë 22.11.2019) dhe BPAL (nënshkruar në datë 02.12.2019); Marrëveshja e Bashkëpunimit Akademik, në Fushën Inxhinierike dhe atë të Kërkimit Shkencor me ALBPETROL sh.a., datë 13.02.2020 (Nr. 270 Prot. i UPT; Nr. 967 Prot. i ALBPETROL);
- Kërkesa e MIE, Nr. 1280 Prot., datë 15.02.2016 “Dërgohet propozimi lidhur me hapjen e Mastër në Gazin Natyror, në Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave”;
- Kërkesa e MIE, Nr. 5300 Prot., datë 19.03.2018 “Ridërgohet propozimi lidhur me hapjen e Mastër në Gazin Natyror, në kuadër të Universitetit Politeknik të Tiranës”.

- Doktoratë në “Konstruksione mekanike dhe vlerësimi i integritetit strukturor”

Ky program studimi është unik në llojin e vet dhe nuk ofrohet nga universitete të tjera në Shqipëri. Ai merret me studime të thella kërkimore shkencore nga fusha e konstruksioneve mekanike, me problematika të elementeve të makinave, analiza të lodhjeve dhe thyerjeve të këtyre elementeve, etj.

Për sa i përket tregut vendas, kemi një zhvillim të ndryshëm duke e krahasuar me periudhën pas viteve 90-të. Gjithmonë e më tepër kërkohet një vlerësim i integritetit të strukturave mekanike, ndaj, lind nevoja e formimit të ekspertëve për të vlerësuar këto struktura duke përdorur metoda të reja, të avancuara dhe krijimin e modeleve apo standardeve për vlerësimin e tyre.

Ekspertët për vlerësimin dhe dhënien e një raporti për integritetin e struktues së një detaji apo strukturës në përgjithësi, janë shumë të paktë në numër si në Shqipëri, ashtu edhe në disa vende të rajonit.

III. TË DHËNA MBI REALIZIMIN E KËRKIMIT SHKENCOR NË UPT

Kuadri i përgjithshëm i punës kërkimore shkencore në Universitetin Politeknik të Tiranës gjatë vitit akademik 2021-2022, është bazuar në Strategjinë Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin 2017-2022, në Planin Strategjik 2019-2024 dhe Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës. Ky aktivitet është në përputhje me misionin dhe principet e përgjithshme të kërkimit shkencor si dhe është bazuar në objektivat afatmesme të zhvillimit të kërkimit shkencor në UPT.

Puna kërkimore shkencore në UPT për vitin akademik 2021-2022 konsiston në:

1. Përparimin shkencor dhe akademik të personelit akademik në UPT, nëpërmjet punës kërkimore shkencore për fitimin e gradave shkencore dhe titujve akademikë,
2. Botime në revista shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.
3. Pjesëmarrje në aktivitete shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.
4. Pjesëmarrje në projekte kërkimore-shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.
5. Hartim, aplikim dhe fitim të projekte të ndryshme kërkimore dhe infrastrukture për modernizimin e kërkimit shkencor.
6. Pjesëmarrje si anëtar i bordit editorial dhe oponentë në revistave shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare të indeksuara.
7. Çmime kombëtare/ndërkombëtare për punën kërkimore shkencore, Patenta të regjistruara brenda ose jashtë vendit,
8. Studime shkencore të kërkuara nga kompani dhe ente shtetërore dhe private,
9. Bashkëpunime me sektorin e prodhimit.
10. Arkiva shkencore.
11. Marrëveshje ndër-institucionale në kuadër të kërkimit shkencor.

Gjatë vitit akademik 2021-2022, kërkimi shkencor është realizuar nga personeli akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme i 7 (shtatë) njësive kryesore, fakulteteve, si dhe nga kërkuesit shkencorë të Institutit të Gjeoshkencave (IGJEO) të Universitetit Politeknik të Tiranës.

Aktiviteti kërkimor i stafit akademik të UPT-së përfshin aktivitetin e stafit akademik me kohë të plotë, i cili, bazuar në Udhëzimin Nr. 29, datë 10.09.2018, “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL”, i ndryshuar, realizon një numër të caktuar orësh kërkimi shkencor (30%) gjatë një viti akademik, si dhe aktivitetin e kërkuesve shkencorë me kohë të plotë, të cilët, realizojnë një numër të caktuar orësh kërkimi shkencor (70%) gjatë një viti akademik, të zhvilluara konform planifikimit të kërkimit shkencor në njësitë bazë, kryesore dhe në nivel institucioni.

1. Burime të kërkimit shkencor

UPT	NUMER
Njësi kryesore	8
Departamente/Qendra kërkimi	30
Laboratorë	61
Biblioteka	9
Shkolla Doktrate	9
Programe të ciklit të dytë, Master	26
Personel akademik dhe kërkues shkencorë	382
Laborantë	72
Struktura/Drejtori në mbështetje të KSH	2
Studentë	15173

2. Fitimi i gradave shkencore dhe titujve akademikë

UPT i konsideron me rëndësi jetike burimet njerëzore cilësore, në të gjithë veprimtaritë e tij akademike dhe shkencore dhe synon:

- të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë e të mbrojë dijet me anën e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve, si edhe të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj;
- të ofrojë një mjedis tërheqës dhe krijues për personelin e ri akademik, duke përsosur mekanizmat për rritjen e mobilitetit dhe mbështetjen e tyre;
- të maksimizojë arritjet e personelit të tij akademik;
- të garantojë mundësi të barabarta për zhvillimin e karrierës së personelit akademik të të gjitha niveleve, etj.

UPT mbështet një strategji të qëndrueshme për zhvillimin e stafit akademik, duke iu referuar të gjitha fazave të aktivitetit të tij, nga përzgjedhja e punësimi dhe deri tek kualifikimi i vazhdueshëm e transmetimi i qëndrueshëm i eksperiencës.

Kjo strategji konsiston në këto pika të forta dhe praktika të mira:

- Zhvillimi i karrierës së personelit akademik, në respekt të lirisë akademike, meritës dhe në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

- Liri akademike për personelin akademik në mësimdhënie, punë kërkimore-shkencore, kontribut institucional dhe kontribut profesional.
- Të drejtat e personelit akademik për të përparuar në karrierën akademike, për t'u trajnuar dhe kualifikuar në institucionet akademike e kërkimore- shkencore, brenda dhe jashtë vendit; për të kryer detyra akademike, shkencore, ose në mbështetje institucionale ndaj të tretëve, brenda kohës efektive të punës, në përputhje me statutin dhe rregulloret e UPT.
- Kualifikimi i vazhdueshëm i personelit ndihmës-akademik dhe administrativ.
- Sigurimi dhe promovimi i lidhjeve të vazhdueshme me institucionet dhe universitetet homologe të huaja, europiane dhe më gjerë, përmes marrëveshjeve të qendrueshme të bashkëpunimit dhe projekteve të përbashkëta kërkimore-shkencore, në nivelin e kualifikimit akademiko-shkencor të stafit akademik, por edhe të shkëmbimit të eksperiencave në këto fusha.
- Konsolidimi i formimit të vazhduar, me fokus globalizimin e tri formave të saj: zhvillim personal, zhvillim në raport me nevojat e institucionit dhe zhvillim profesional.
- Konsolidimi i studimeve të doktoraturës, në të gjitha njësitë, si një strukturë tepër e rëndësishme për përzgjedhjen e stafit të ri akademik dhe të kualifikimit të atij ekzistues.

a. Grada Shkencore “Doktor”


Gjatë vitit akademik 2021-2022 në UPT janë fituar në total 57 grada shkencore “Doktor”.

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 99, datë 5.2.2020 “Për disa ndryshime në Vendimin Nr. 777, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për kontrollin anti-plagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore”, të gjithë disertacionet e kandidatëve doktorantë i janë nënshtruar verifikimit anti-plagjiaturë pranë njësive kryesore të përkatësisë.

Në kuadër të respektimit të politikave mbështetëse për promovimin e stafit akademik të UPT-së, institucioni ka kryer rimbursimin e tarifës së kontrollit antiplagjiaturë për personelin me kohë të plotë të UPT-së.

Shpërndarja e gradave shkencore “Doktor” të fituara në vitin akademik 2021-2022, sipas fakulteteve të UPT-së, pasqyrohet në grafikun më poshtë:

Tabela 2: Gradat shkencore të fituara gjatë vitit akademik 2021-2022, sipas fakulteteve.



FAKULTETI	DOKTORATA TË PËRFUNDUARA 2021-2022
FIN	17
FAU	7
FIMIF	7
FTI	4
FIE	2
FIM	4
FGJM	11
IGJEO	5
TOTAL	57

Figura 1: Shpërndarja e gradave të fituara sipas njësive kryesore

Numrin më të lartë të fitimit të gradës shkencore “Doktor” e kanë:

Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit me 17 grada shkencore “Doktor” dhe Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minerave me 11 grada shkencore “Doktor”.




Figura 2: Shpërndarja e gradave të fituara sipas njësive dhe avancimit të personelit akademik të UPT-së.

Nga 57 grada shkencore “Doktor” të fituara gjatë vitit akademik 2021-2022, 31 prej tyre janë fituar nga personeli akademik me kohë të plotë, i njësive kryesore të UPT-së.

Shpërndarja e numrit të gradave shkencore “Doktor” të fituara gjatë vitit akademik 2021-2022, duke e krahasuar me shpërndarjen e numrit të gradave shkencore “Doktor” të fituara një vit më parë, sipas njësive kryesore të UPT-së dhe në total, pasqyrohet në grafikun më poshtë:




Figura 3: Krahasimi i fitimit të grades shkencore “Doktor” sipas njësive kryesore, në dy vitet e fundit.

Vihet re se, gjatë vitit akademik 2021-2022 janë mbrojtur një numër i konsiderueshëm gradash shkencore “Doktor”, krahasimisht me vitin e mëparshëm akademik.

b. Titujt akademikë “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor”

UPT promovon dhe jep titujt akademikë “Profesor” dhe “Profesor i Asociuar” jo vetë për personelin akademik me kohë të plotë në UPT por dhe për Institucionit e Arsimit të Lartë publike dhe private në Republikën e Shqipërisë . Kjo e drejtë e UPT-së buron nga plotësimi i kriterëve ligjore në fuqi, për ngritjen e Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik (KPPA).

Gjatë vitit akademik 2021-2022, KPPA ka realizuar 11 mbledhje për shqyrtimin e dosjeve për fitimin e titujve akademikë. Në këto mbledhje janë shqyrtuar 31 dosje prej të cilave, 12 e kanë kaluar pozitivisht procesin e vlerësimit, kurse 5 prej tyre nuk i kanë përmbushur kriteret e vlerësimit. Momentalisht, pranë KPPA-së janë në proces shqyrtimi 14 dosje: 2 dosje për fitimin e titullit “Profesor” dhe 12 dosje për fitimin e titullit “Profesor i Asociuar”.

UPT mbështet në mënyrë të vazhdueshme jo vetëm kualifikimin e vazhdueshëm të stafit të tij akademik por inkurajon dhe bën përpjekje, që të sigurojë bashkëpunim me institucione të tjera homologe në vend, me qëllim ngritjen e kapaciteteve dhe aftësive shkencore-kërkimore të stafeve të tyre akademike duke kontribuar në promovimin e kërkimit shkencor në nivel kombëtar.

Shpërndarja e titujve akademikë dhënë në UPT nga KPPA për vitin akademik 2021-2022 jepet në figurën e mëposhtme.

SHPËRNDARJA E TITUJVE AKADEMIKË




Figura 4. Gradat dhe titujt akademik të fituara gjatë vitit akademik 2021-2022

- KPPA ka dhënë 4 tituj “Profesor” në total: 2 tituj “Profesor” i janë dhënë anëtarëve të stafit akademik të UPT-së dhe 1 titull “Profesor” i është dhënë një anëtari të stafit akademik të Universitetit Epoka dhe 1 titull “Profesor” i është dhënë një anëtari të stafit akademik të Universitetit të New York Tiranë.

- KPPA ka dhënë 8 tituj “Profesor i Asociuar” në total: 4 tituj “Profesor i Asociuar” i janë dhënë anëtarëve të stafit akademik të UPT-së dhe 4 tituj “Profesor i Asociuar” i janë dhënë anëtarëve të stafit akademik të universiteteve të tjera.

- Dy tituj Profesor i Asociuar dy anëtarëve të stafit akademik të Universitetit EPOKA, Tiranë.
- Një titull Profesor i Asociuar një anëtari të stafit akademik të Universitetit Ismail Qemali, Vlorë.
- Një titull Profesor i Asociuar një anëtari të stafit akademik të Albanian University, Tiranë.

Janë caktuar 24 relatorë për vlerësimin e dosjeve nga pikëpamja e plotësisë së dokumentacionit si dhe janë ngritur 13 Juri për vlerësimin e dosjeve.

Tabela 3: Shpërndarja e gradave shkencore dhe titujve akademikë për vitin akademik 2021-2022, sipas njësive kryesore.

SHPËRNDARJA E GRADAVE DHE TITUJVE AKADEMIKË					
NJESIA KRYESORE	Docent	Doktor	Prof. Asoc.	Prof. Dr.	Akademik
FIN	0	36	9	0	0
FAU	1	15	2	2	0
FIMIF	0	40	15	9	0
FTI	0	16	9	6	0
FIE	0	13	3	3	1

FIM	0	28	16	5	0
FGJM	0	16	8	19	0
IGJEO	0	19	1	6	1
TOTAL	1	183	63	50	2




Figura 5: Krahasimi në dy vitet e fundit e shpërndarjes së gradave shkencore dhe titujve akademikë sipas njësive kryesore.




Figura 6: Krahasimi në dy vitet e fundit i shpërndarjes së gradave shkencore dhe titujve akademikë në nivel institucioni.

Në krahasim me vitin akademik 2020-2021, për vitin akademik 2021-2022, vihet re një rritje e numrit të personelit akademik me kohë të plotë në UPT, të cilët kanë fituar gradën shkencore “Doktor”, një

rritje e lehtë e numrit të personelit akademik, të cilët kanë fituar titullin akademik “Profesor i Asociuar”, si dhe më pak personel akademik kanë fituar lehtë titullin akademik “Profesor”.

3. Botimet

Gjatë viteve të fundit është kaluar në aplikimin e koncepteve të reja mbi atë çfarë përfaqëson kërkimi shkencor dhe në veçanti në kriteret e vlerësimit të kësaj të fundit, duke u bazuar në standardet europiane dhe praktikatat e universiteteve të tjera me emer në këtë fushë. Kjo është një pikë e fortë në këtë drejtim. Në përputhje me këto koncepte të reja, kërkimi shkencor i vërtetueshëm është matur dhe monitoruar në vizibilitet (publikime të botuara dhe revista prestigjioze) si dhe rezultatet e hulumtimit janë kristalizuar dhe çertifikuar nëpërmjet botimit të librave dhe artikujve shkencorë dhe shkollorë.

Shpërndarja e rezultateve të kërkimit shkencor është realizuar kryesisht në revista prestigjioze/ISSN brenda dhe jashtë vendit, Tabela 4.

Tabela 4: Botimet e realizuara gjatë vitit akademik 2021-2022 sipas njësive kryesore.

BOTIME TE REALIZUARA							
FAKULTETI	Tekste shkollore	Monografi shkencore brenda vendit	Monografi shkencore jashte vendi	Artikuj në revista periodike shkencore brenda vendit (shqip dhe gjuhë të huaj)	Artikuj në revista dhe periodike në revista shkencore jashtë vendit	Artikuj në revista të indeksuara SCOPUS apo CLARIVATE	Nr. Total i botimeve të realizuara
FIN	0	1	0	4	25	0	30
FAU	0	1	3	1	9	3	17
FIMIF	3	2	0	0	15	33	53
FTI	0	0	0	0	6	2	8
FIE	2	0	0	1	1	4	8
FIM	2	0	0	5	39	8	54
FGJM	0	0	0	6	12	14	32
IGJEO	0	1	3	4	12	5	25
TOTAL UPT	7	5	6	21	119	69	227

a. Tekste shkollore:

Janë botuar **7 tekste shkollore**, nga këto: 3 nga FIMIF, 2 nga FIE dhe 2 nga FIM.

b. Monografi shkencore brenda dhe jashtë vendit:

Janë botuar **5 monografi shkencore brenda vendit**, nga këto: 1 nga FIN, 1 nga FAU, 2 nga FIMIF dhe 1 nga IGJEO.

Gjatë vitit akademik 2021-2022, nga njësitë kryesore të UPT-së, vetëm në dy prej tyre, personeli akademik me kohë të plotë i tyre ka botuar **monografi shkencore jashtë vendit**, përkatësisht: FAU 3 (tre) dhe IGJEO 3 (tre) monografi shkencore.

- c. **Artikuj në revista shkencore brenda vendit (shqip dhe gjuhë të huaj) janë realizuar 21.** Numrin më të madh të artikujve të botuar e zë FGJM me 6 artikuj, dhe vijohet me 5 artikuj nga FIM, 4 artikuj nga IGJEO, 4 artikuj nga FIN dhe nga 1 artikull FAU dhe FIE.
- d. **Artikuj dhe periodikë në revista shkencore jashtë vendit janë realizuar 119.** Numrin më të madh e kanë realizuar stafi akademik i FIM me 39 artikuj, ndiqet nga FIN me 25 artikuj, FIMIF me 15 artikuj, FGJM dhe IGJEO me 12 artikuj secila, FAU me 9 artikuj, FTI me 6 artikuj, dhe FIE me 1 artikull.
- e. **Artikuj në revista të indeksuara Scopus/Clarivate janë realizuar 69.** Numrin më të madh e kanë realizuar stafi akademik i FIMIF me 33 artikuj, FGJM me 14 artikuj, FIM me 8 artikuj, IGJEO me 5 artikuj, FIE me 4 artikuj, FAU me 3 artikuj dhe FTI me 2 artikuj.
- f. **Numrin më të madh të botimeve të realizuara në total për njësi kryesore e kanë FIM me 54 botime, FIMIF me 53 botime, FGJM me 32 botime, FIN me 30 botime, IGJEO me 25 botime, FAU me 17 botime, FIE dhe FTI me nga 8 botime secila.**




Figura 7: Krahasimi në dy vitet e fundit i totalit të botimeve, sipas njësite kryesive.

Tabela 5: Vlerësuesit e artikujve dhe numri i artikujve të vlerësuar

Njësi kryesore	Numri i vlerësuesve të artikujve në revista shkencore brenda dhe jashtë vendit	Numri i artikujve në revista shkencore brenda dhe jashtë vendit, të vlerësuara nga personeli akademik i njësisë kryesore
FIN	0	0
FAU	2	5
FIMIF	1	27
FTI	1	1
FIE	1	1
FIM	3	4
FGJM	2	2
IGJEO	2	3
TOTAL	12	43




Figura 8: Vlerësuesit e artikujve dhe numri i artikujve të vlerësuar sipas njësive kryesore.

Siç shihet nga tabela 5 dhe figura 8, personeli akademik i FIMIF ka numrin më të lartë të artikujve të vlerësuar.

Tabela 6: Numri i botimeve si autor i parë dhe bashkëautor sipas njësisë kryesore

Njësi kryesore	Numri i botimeve si autor i parë	Numri i botimeve si bashkë autor
FIN	22	18
FAU	10	10
FIMIF	23	43
FTI	8	6
FIE	6	5
FIM	40	41
FGJM	14	28
IGJEO	13	14
TOTAL	136	165

Siç shihet nga tabela 6 numrin më të lartë të botimeve si autor i parë e mban personeli akademik me kohë të plotë në FIM, ndërsa numrin më të lartë të botimeve si bashkëautor e mban personeli akademik me kohë të plotë në FIMIF.

Numrin më të lartë të botimeve si autor i parë dhe bashkë autor e mban FIM me 81 botime në total, ndjekur nga FIMIF me 66 botime në total.




Figura 9: Numri i botimeve si autor i parë dhe bashkëautor sipas njësive kryesore.

Për sa i përket numrit të botimeve si autor i parë dhe numrit të botimeve si bashkëautor, për vitet akademike 2020-2021 dhe 2021-2022, nuk pasqyrohen diferenca të mëdha, si në nivel njësie kryesore ashtu edhe në nivel institucional, figura 9.




Figura 10: Krahasimi i numrit të botimeve si autor i parë në dy vitet e fundit, 2020-2021 dhe 2021-2022.

Nga figura 10 vihat re një rritje e numrit të botimeve si autor i parë në vitin akademik 2021-2022, krahasuar me një vit akademik më parë, si në nivel njësie kryesore ashtu edhe në nivel institucioni. Kontributin më të madh në rritjen e numrit të botimeve si autor i parë për vitin akademik 2021-2022 e ka FIM dhe FIMIF.




Figura 11: Krahasimi i numrit të botimeve si bashkëautor në dy vitet e fundit, 2020-2021 dhe 2021-2022.

Nga figura 11 vihat re një rritje pothuajse dyfish i numrit të botimeve si bashkë autor në vitin akademik 2021-2022, krahasuar me një vit akademik më parë, si në nivel njësie kryesore ashtu edhe në nivel institucioni. Kontributin më të madh në rritjen e numrit të botimeve si bashkëautor e ka FIM dhe FIMIF.

4. Pjesëmarrja në aktivitete shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare si workshope, seminare, konferenca dhe kongrese

Gjithë aktiviteti i kërkimit shkencor në UPT i përshtatet kërkesave të efijencës dhe performances së procesit mësimor, zhvillimit të njohjes dhe teknologjisë, kërkimit të inovacionit, me qëllim përfundimtar prodhimin e rezultateve kerkimore-shkencore të njohura në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Njohja, shpërndarja dhe publikimi i rezultateve të realizuara në UPT është realizua në kuadër të aktiviteteve shkencore si: seminare, workshope dhe konferenca të realizuara nga njesitë kryesore të UPT-së si dhe nga pjesëmarrja e personelit akademik të institucionit në simpoziume, forume shkencore, workshope, konferenca dhe kongrese shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, pjesëmarrje e realizuar me referime, në cilësinë e moderatorit, si anëtar të Komiteteve Shkencore ose si anëtarë të Komiteteve Organizative.

a. Aktivitete kombëtare

Pjesëmarrja e personelit akademik me kohë të plotë në UPT në aktivitete kombëtare si: workshop, simpoziume, konferenca, kongrese gjatë vitit akademik 2021-2022 pasqyrohet në tabelën 7.

Tabela 7: Pjesëmarrja e personelit akademik të njësive kryesore në aktivitete kombëtare, viti akademik 2021-2022

PJESËMARRJE NË AKTIVITETET SHKENCORE KOMBËTARE						
NJESIA KRYESORE	Konferenca, kongrese të organizuara nga Departamenti/ Fakulteti	Seminare, workshope të organizuara nga Departamenti/ Fakulteti	Pjesëmarrje me referime në aktivitete shkencore kombëtare (simpoziume, kongrese, konferenca)	Pjesëmarrje si moderator në aktivitete shkencore kombëtare (simpoziume, kongrese, konferenca)	Pjesëmarrje në aktivitete shkencore kombëtare si anëtarë të Komitetit Shkencore	Pjesëmarrje në aktivitete shkencore kombëtare si anëtarë të komitetit Organizativ
FIN	0	1	6	0	3	1
FAU	0	1	1	1	0	0
FIMIF	0	0	0	5	0	2
FTI	0	0	0	1	0	0
FIE	0	1	12	4	3	1
FIM	6	0	12	19	8	3
FGJM	0	0	10	0	0	2
IGJEO	1	0	53	1	2	6
TOTAL	7	3	94	31	16	15

Njësitet kryesore të UPT, të cilat kanë pjesëmarrjen më të lartë të personelit akademik në aktivitete shkencore kombëtare janë IGJEO me 63 pjesëmarrje dhe FIM me 48 pjesëmarrje.

Krahasimi i pjesëmarrjes së personelit akademik sipas njësive kryesore, në në aktivitete shkencore kombëtare, për vitet akademike 2020-2021 dhe 2021-2022 është dhënë në figurën 12.




Figura 12: Krahasimi i pjesëmarrjes së personelit akademik të njësive kryesore në aktivitete kombëtare, në dy vitet e fundit, 2020-2021 dhe 2021-2022.

Siç shihet qartë nga figura 12 pjesëmarrja e personelit akademik të UPT-së në aktivitete kombëtare, pasqyron diferenca të mëdha, duke patur një rritje dyfish të pjesëmarrjes së personelit akademik në aktivitete kombëtare, krahasuar me një vit akademik më parë, si në nivel njësie kryesore ashtu edhe në nivel institucioni.

b. Aktivitete ndërkombëtare

Pjesëmarrja e personelit akademik me kohë të plotë në UPT në aktivitete ndërkombëtare si: workshop, simpoziume, konferenca, kongrese gjatë vitit akademik 2021-2022 pasqyrohet në tabelën 8.

Tabela 8: Pjesëmarrja e personelit akademik të njëjësive kryesore në aktivitete ndërkombëtare, 2021-2022.

NJESIA KRYESORE	Konferencaworkshop të organizuara nga Departamenti /Fakulteti	Workshope të organizuara nga Departamenti/Fakulteti	Pjesëmarrje me referime në aktivitete shkencore ndërkombëtar (simpoziume, workshope, kongrese, konferenca)	Pjesëmarrje si moderatorë në aktivitete shkencore ndërkombëtare (simpoziume, workshope, kongrese, konferenca)	Pjesëmarrje në aktivitete shkencore ndërkombëtare si anëtarë të Komitetit Shkencor dhe vlerësues i punimeve të aktivitetit	Pjesëmarrje në aktivitete shkencore ndërkombëtare si anëtarë të Komitetit Organizativ
FIN	0	0	69	4	1	0
FAU	0	0	18	3	17	1
FIMIF	0	0	53	0	0	1
FTI	1	0	52	7	21	9
FIE	1	0	31	1	1	6
FIM	2	0	93	3	9	1
FGJM	0	0	26	2	21	2
IGJEO	1	0	43	1	1	1
TOTALI	4	0	385	21	71	21

Krahasimi i pjesëmarrjes së personelit akademik, sipas njëjësive kryesore, në aktivitetet shkencore ndërkombëtare, për vitet akademike 2020-2021 dhe 2021-2022 është dhënë në figurën 13.




Figura 13. Krahasimi i pjesëmarrjes së personelit akademik të njësive kryesore në aktivitete ndërkombëtare, në dy vitet e fundit, 2020-2021 dhe 2021-2022.

Për sa i përket pjesëmarrjes së personelit akademik në aktivitete ndërkombëtare shihet qartë nga figura 13, se ka rritje të pjesëmarrjes së personelit akademik, krahasuar me një vit akademik më parë, si në nivel njësie kryesore ashtu edhe në nivel institucioni.

Gjatë vitit akademik 2021-2022 vihet re një pjesëmarrje më e lartë e stafit akademik të njësive kryesore në UPT në aktivitete shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.




Figura 14. Shpërndarja e numrit të aktiviteteve kombëtare dhe ndërkombëtare sipas njësive kryesore, viti akademik 2021-2022.

Gjatë vitit akademik 2021-2022 janë organizuar tre konferencave të rëndësishme ndërkombëtare nga njësitë kryesore në UPT, me pjesëmarrje të gjerë nga Universitetet brenda dhe jashtë vendit, si mëposhtë:

- 1- “9th International Textile Conference” dhe “3rd International Conference on Engineering and Entrepreneurship 2021”, 18-19 Nëntor 2021, organizuar nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike.
- 2- “The 1st International Conference on Information Technologies and Educational Engineering (ICITEE21)”, 19-20 Nëntor 2021, organizuar nga Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit.
- 3- “Konferenca e parë Ndërkombëtare për Energjitë e Ripërtërishme dhe Teknologjitë e Mençura, REST”, 28-30 Korrik 2022, organizuar nga Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike.



5. Pjesëmarrja në projekte kërkimore shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare

Rritja e veprimtarisë ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor, nëpërmjet pjesëmarrjes në programet dhe projektet kërkimore kombëtare, evropiane dhe rajonale dhe më gjerë, është e një rëndësie të veçantë të UPT, në përmbushjen e misionit dhe politikave të tij mbi kërkimin shkencor.

UPT, ka mbështetur dhe promovuar kërkimin aplikues dhe inovacionin nëpërmjet projekteve kombëtare, ndërkombëtare si dhe rrjeteve kërkimore shkencore, pjesë e të cilave ka qenë me përfaqësues nga fakultetet apo Instituti i Gjeoshkencave, në cilësinë e kordinatorit ose partnerit.

Tabela 9: Pjesëmarrja e personelit akademik në projekte kërkimore shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas njësive kryesore.

PJESËMARRJA NË PROJEKTE KËRKIMORE-SHKENCORE (KOMBËTARE & NDËRKOMBËTARE)								
NJESIA KRYESORE	Pjesëmarrje në Projekte Kombëtare	Pjesëmarrja në Projekte Financuar nga AKKSHI	Pjesëmarrja në Projekte Kombëtare (kompani/ ministri/ shtetërore/ private)	Pjesëmarrja në Projekte Ndërkombëtare Erasmus +	Pjesëmarrja në Projekte Ndërkombëtare CB (Capacity Building Project)	Pjesëmarrja në Projekte Ndërkombëtare H 2020	Pjesëmarrja në Projekte te tjera Ndërkombëtare	Pjesëmarrje në hartimin dhe aplikimin e projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare
FIN	0	0	7	10	11	0	4	0
FAU	3	2	0	18	2	0	7	1
FIMIF	0	4	1	12	0	0	2	2
FTI	6	10	0	1	5	0	0	10
FIE	0	0	0	4	2	0	4	1
FIM	0	16	1	8	0	0	4	3
FGJM	0	26	4	9	8	1	16	56
IGJEO	7	35	19	0	0	0	32	10
TOTALI	16	93	32	62	28	1	69	83

*Shënim: Një personel akademik mund të jetë pjesëmarrës në më shumë se një projekt kombëtar ose ndërkombëtar.

Gjatë vitit akademik 2021-2022, rezultojnë 301 pjesëmarrje të anëtarëve të personelit akademik dhe ndihmës akademik të UPT-së në projekte kërkimore shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare. Pjesëmarrja më e lartë në projekte është në Projektet e financuara nga AKKSHI, e pasuar nga pjesëmarrja në projekte të tjera ndërkombëtare. Gjithashtu, vihet re një numër i lartë i personelit akademik që ka marrë pjesë në hartimin dhe aplikimin në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, Tabela 9.

Në figurën 15 jepet krahasimi i pjesëmarrjes së personelit akademik të njësive kryesore në projekte, në dy vitet e fundit, 2020-2021 me 2021-2022.




Figura 15: Krahasimi i pjesëmarrjes së personelit akademik të njësive kryesore në projekte, në dy vitet e fundit, 2020-2021 dhe 2021-2022.

*Shënim: Një personel akademik mund të jetë pjesëmarrës në më shumë se një projekt kombëtar ose ndërkombëtar.

Për sa i përket pjesëmarrjes së personelit akademik në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, pasqyrohen diferenca shumë të mëdha, një rritje më shumë se dy fishi, krahasuar me një vit akademik më parë, si në nivel njësie kryesore ashtu edhe në nivel institucioni. Rritjen më të lartë në nivel njësie kryesore e paraqet IGJEO dhe FGJM.




Figura 16: Shpërndarja e projekteve, sipas llojit të projektit dhe njësive kryesore të UPT.

*Shënim: Në një projekt mund të jenë përfshirë më shumë se një njësi kryesore.

Përfshirja më e lartë në projekte e personelit akademik, për çdo njësi kryesore është kryesisht në projektet ndërkombëtare, pasuar nga përfshirja në projekte të AKKSHI-t.

Informacioni i hollësishëm mbi emërtimin, kohëzgjatjen, partnerët dhe numrin e projektit, pasqyrohet në kapitullin VII. “Shtojca Nr.1: Raportet e punës kërkimore shkencore të njësisve kryesore të UPT-së”.

Fushat kryesore në të cilat është bashkëpunuar në projektet kërkimore-shkencore për vitin akademik 2021-2022, renditen si më poshtë:

Tabela 10: Fushat kryesore të bashkëpunimit në projekte

NJËSIA KRYESORE	FUSHA E BASHKËPUNIMIT
IGJEO	Gjeologji, Hartografim, Korelim, Petrologji, Gjeokimi, Stratigrafi, Paleontologji, Karst, Harta gjeologjike, Tektonike, Gjeologjia Regjionale, Hidrogeologji, Gjeologji Mjedisi, Gjeofizikë, Modelim materialesh, Klimë, Rreziku sizmik, Gjeoinformatikë, Energjia Gjeotermale, Modelimi i deformimeve, Sismologjia e tërmeteve dhe Sismologjia e aplikuar, Përmirësimi i hartës sizmike, Ndërtimi i Modelimit hidrologjik për lumenjtë, Digjitalizimi i të dhënave të niveleve të lumit, Përdorimi i Modelit Hidrologjik Panta Rhei.
FGJM	Sedimentol, Stratigrafi, Arkiologji, Gjeodezi, Gjeofizike, Ndryshimet klimatike dhe gazet serre, Gjeoinformatike, Shkenca toke, Gjeologji Regjionale, Gjeodinamik, Emergjencat Civile, Gjeologjia e Aplikuar, Hidrokarbure, Gjeologji inxhinierike, Gjeologji urbane, Gazi Natyror
FIN	Standarde dhe kushte teknike në fushën e Ndërtimit, Teknologjitë e trajtimit të ujit të ndotur, Energji dhe Mjedisi, Gjeoinformatik, Infrastrukturat e të dhënave hapësinore, Vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut.
FTI	Sistemet dhe Teknologjitë e Informacionit, Kërkim shkencor dhe Inovacion, Shkencat Kompjuterike.
FIE	Laboratori i trajnimit të teknologjive të rrjetit inteligjent, Simetri më të larta për të projektuar pajisjet rrezatuese sfidat dhe aplikimet industriale, Ruajtja dhe eficientia e përdorimit të energjisë elektrike, Rrjeti, Analiza e elasticitetit
FIM	Energji, Energjitikë, Energjitë e Rinovueshme, Energji – Metalurgji, Transport, Mjete lëvizëse, Sistemet dhe teknologjitë e informacionit, Dixhitalizim i trashëgimisë kulturore
FAU	Urbanistikë, Arkitekturë, Arkeologji industriale, Konservimi dhe Restaurimi i Trashëgimisë Kulturore.
FIMIF	Fusha e arsimit të lartë, Biodiversiteti dhe mjedisi, Nano teknologji, Fizikë e aplikuar në mjekësi.

a. Aplikime në Projekte të AKKSHI

Në tabelën 11 janë dhënë aplikimet e njësisë bazë dhe kryesore në AKKSHI për projekte kombëtare të kërkimit dhe zhvillimit (PKZH), Mars 2022.

Tabela 11: Aplikimet në kuadër të thirrjes së AKKSHI 2022 për projekte kombëtare të kërkimit dhe zhvillimit (PKZH)

Nr	Data	Emërtimi i Departamentit/njesisë kryesore	Emërtimi i projektit
1	02.03.2022	Departamenti i Prodhim Menaxhimit/FIM	Modelimi dhe optimizimi i proceseve e podhimit te produkteve te zinxhirit te furnizimit ne Shqiperi
2	02.03.2022	Departamenti i Inxhinierise Fizike/ FIMIF	Zhvillimi i modeleve te simulimit e parashikimit dhe integrimi me databazen TCIA te imazheve mjekesore
3	02.03.2022	FIM	Analiza inxhinierike e aksidenteve rrugore ne Shqiperi, si nje qasje reaktive ndaj sigurise rrugore
4	02.03.2022	Departamenti i Prodhim Menaxhimit/FIM	Hartimi i nje plani veprimi mbi eficencen e energjise (EE) ne sektorin e industrise se rende
5	03.03.2022	Departamenti i Elektronikes dhe Telekomunikacionit/FTI	Transmetimet audiovizive digjitale ne epoken e transmetimeve me brez te gjere 5G ne Shqiperi: Teknika, teknologji, politika dhe rekomandime inovative per perdorimin efikas te spektrit.
6	03.03.2022	Departamenti i Bazave te Informatikes/ FTI	Perdorimi i metodave te Inteligjences Artificiale ne Perpunimin e Teksteve ne Gjuhen Shqipe
7	04.03.2022	Departamenti i Burimeve te Energjisë/FGJM	Modelimi 3D i vendburimeve hidrokarbure-Rezervat-Treguesit e perpunimit-Metodat e permiresimit te naftenxjerrjes

b. Aplikimet në kuadër të thirrjes së AKKSHI 2022 për projekte bilaterale me Turqinë (TUBITAK)

Në tabelën 12 janë dhënë aplikimet e njësisë bazë dhe kryesore në AKKSHI 2022 për projekte bilaterale me Turqinë (TUBITAK), Mars 2022.

Tabela 12: Aplikimet në kuadër të thirrjes së AKKSHI 2022 për projekte bilaterale me Turqinë (TUBITAK)

Nr	Data	Emërtimi i Departamentit/njesisë kryesore	Emërtimi i projektit
1	02.03.2022	Departamenti i Prodhim Menaxhimit/ FIM;	Pergatitja e veshjeve siperfaqsores dhe vetepastruese per qelizat voltaike

2	07.03.2022	FTI	Realizimi i nje sistemi te bazuar ne inteligjencen artificiale per diagnostifimin e shpejte dhe analizen e riskut e pacienteve me Covid-19
3	08.03.2022	Departamenti i Tekstilit dhe Modes/ FIM;	Zhvillimi i tekstileve pa thurje percjellese te elektricitetit te veshura me Ppy dhe PANI, me peshe te lehte dhe mikro-fibra, per mbrojtje efikase nga nderhyrjet elektromagnetike
4	09.03.2022	Departamenti i Mekanikes se strukturave/FIM	Aplikimi i metodave te shpejta vizuale per vleresimin e potencialit te rrishtit sizmik te strukturave prej betoni te armuar dhe me mure mbajtese
5	09.03.2022	Departamenti i Elektronikes dhe Telekomunikacionit/FTI	Grumbullim dinamik optimal i sherbimeve te shumta per Burimet e Shperndara te Energjise
6	09.03.2022	Departamenti i Automatikes/FIE;	Integrimi i qendrueshem i sistemit te energjise se rinovueshme me ruajtjen e energjise ne sistemin e shperndarjes se Turqise dhe Shqiperise
7	09.03.2022	Departamenti i Elektronikes dhe Telekomunikacionit/FTI	Marreveshja e Tregtise se Lire Turqi-Shqiperi; Strategji te reja per rritjen e tregtise ndermjet dy vendeve ne epoken dixhitale
8	09.03.2022	Departamenti i Tekstilit dhe Modes/ FIM	Edukimi dixhital ne Industrine e Modes
9	09.03.2022	Departamenti i Shkencave te Tokes/ FGJM	Kushtet e formimit dhe potencialet ekonomike te fosforiteve: Nje korrelacion I formacioneve te Kretakut te Siperme te Shqiperise dhe Turqise

c. Projekte të fituara

Në tabelën 13 janë dhënë projektet e fituara nga AKKSHI.

Tabela 13: Lista e projekteve të fituara

Nr	Data	Emërtimi i Departamentit/njesisë kryesore	Emërtimi i projektit
1	02.03.2022	Departamenti i Prodhim Menaxhimit/ FIM	Modelimi dhe optimizimi i proceseve e podhimit te produkteve te zinxhirit te furnizimit ne Shqiperi
2	02.03.2022	Departamenti i Inxhinierise Fizike/ FIMIF	Zhvillimi i modeleve te simulimit e parashikimit dhe integrimi me databazen TCIA te imazheve mjekesore
3	02.03.2022	Departamenti i Prodhim Menaxhimit/FIM	Hartimi i nje plani veprimi mbi eficencen e energjise (EE) ne sektorin e industrise se rende
4	03.03.2022	Departamenti i Elektronikes dhe Telekomunikacionit/FTI	Transmentimet audiovizive digjitale ne epoken e transmetimeve me brez te gjere 5G ne Shqiperi: Teknika, teknologji, politika dhe rekomandime inovative per perdorimin efikas te spektrit.
5	03.03.2022	Departamenti i Bazave te Informatikes/ FTI	Perdorimi i metodave te Inteligjences Artificiale ne Perpunimin e Teksteve ne Gjuhen Shqipe
6	04.03.2022	Departamenti i Burimeve te Energjise/FGJM	Modelimi 3D i vendburimeve hidrokarbure-Rezervat-Treguesit e perpunimit-Metodat e permiresimit te naftenxjerrjes

d. Projekte në proces

Në tabelën 14 janë dhënë projektet ndërkombëtare në proces.

Tabela 14: Lista e projekteve në proces

Nr.	Projekte në proces	Akronimi	Nr. Reference
1	ENGINEERING curricula modernisation in renewable eNergy in albanian univErsities	ENGINE	619339-EPP-1-2020-1-AL-EPPKA2-CBHE-JP
2	Knowledge triangle for a low carbon economy	KALCEA	618109-EPP-1-2020-1-EL-EPPKA2-CBHE-JP
3	Higher Education, Enterprise platform for fostering, modernisation and sustainable growth in natural stone industry in Western Balkans	BKSTONE	610483-EPP-1-2019-1-AL-EPPKA2-CBHE-JP
4	improving REsearch capacities of Albanian higher education institutions in conservation and restoration of Cultural Heritage	REACH	610390-EPP-1-2019-1-AL-EPPKA2-CBHE-SP
5	Developing Research and Innovation Capacities in Albania and Kosovo	DRIVE	610307-EPP-1-2019-AL-EPPKA2-CBHE-JP
6	Business driven problem-based learning for academic excellence in geoinformatics	GEOBIZ	601225-EPP-1-2019-1-HR-EPPKA2-CBHE-JP
7	Reforming doctoral studies in montenegro and albania – good practice paradigm	MARDS	598465-EPP-1-2018-1-ME-EPPKA2-CBHE-SP
8	Comprehensive risk assesment of basic services and transport infrastructures	CRISIS	101004830

Projektet e aplikuara në projektin european Erasmus + 2022 janë dhënë si më poshtë:

Nr.	Fakulteti	Akronimi	ID	Lloji I tematikes	Roli	Contact person of the coordinator	Roli	Contact point UPT	Status
					Coordinator		Partner		
1	FTI	DLAWB		Strand 2	UPT	Evis Trandafil		Evis Trandafil	deleted
2	UPT	TRACE	101082774	Strand 3	Universiteti Polis	Flora Krasniqi	UPT	Alma Afezoll	rejected
4	FIN	IFUTURE	101082815	Strand 2	Universiteti i Tiranës	Elona Pojani	UPT	Oltion Marko	invited
5	FGJM	RESTART	101082855	Strand 2	Sveuciliste U Dubravniku	Nebojsa Stojic	UPT	Aida Bode	rejected
6	FTI	UP	101082862	Strand 2	Universiteti I Prishtines	Kyvetë Shatri	UPT	Elinda Mece	reserve list
8	FIM	DERHE	101082066	Strand 2	Univerza V Ljubljani	Tomaz Berlec	UPT	Valma Prifti	rejected
9	FTI	EMECISplus	101082389	Erasmus Mundus Joint Masters	Universita Degli Studi I Genova	Simona Sacone	UPT	Elinda Mece	rejected
10	FIM	DGTRANS	101082187	Strand 2	University of Mitrovica	Nebojsa Arsic	UPT	Genti Guxho	invited
11	FIM	INTEC	101081873	Strand 2	FH Joanneum Gesellschaft MBH	Kurt Steiner	UPT	Odhisea Koca	invited
12	FIN	SmartWB	101081724	Strand 2	Javna Ustanova Univerziteti e Gore Podgorica	Marija Jevric	UPT	Bilbil Nurce	invited
13	FIN	B-MARE	101083050	Strand 2	Universiteti Aleksander Moisiu Durres	Dorinela Cupi	UPT	Alma Afezoll	rejected
14	FTI	IoT-ECO	101083018	Strand 2	University of Sofia	Galia Marinova	UPT	Enida Sheme	invited
15	FTI	ARTISAN	101083016	Strand 2	Universiteti I Prishtines	Eliot Bytyci	UPT	Bojken Shehu	rejected
16	FAU	DArch	101083155	Strand 2	Universiteti Polis	Elona Karafil	UPT	Alma Afezoll	rejected
17	FTI	ERA Cyber-Sec in AL	101083093	Strand 1	Universiteti Luarasi Sh.p.k	Ani Dasho	UPT	Elinda Mece	rejected
18	FIM	Ret4web	101082714		Universiteti European I Tiranës	Kebjana Haka	UPT	Majlinda Alcani	rejected
19	FTI	EUSIS	101085185	JMO			UPT	Igli Tafa	invited
20	FTI	Digi4Wearables	Sep-210854476	CB-VET	Centro Tecnológico de Calçado de Portugal	Agnes Vitaniotou	UPT	Tatjana Spahiu	invited
21	FIMIF	ISTA-EU	101085776	JMO				Joan Jani	invited
22		ReScale	101037653	H2020-LC-GD-2020-3			UPT	Elfrida Shehu	rejected
23		AI4LT					UPT	Elinda Mece	rejected
24		INOVILLA	101084545	HORIZON-CL6-2022-COMMUNITIES				Florian Nepravishta	rejected
25		TCIA database AL101088890ER C-2022-COG						Altin Gjevori	rejected
26		ISRA	101101255	UCPM-2022-PP				Neritan Shkodrani	Invited

Figura 17: Projektet e aplikuara Erasmus + 2022

6. Pjesëmarrje si anëtar i bordit editorial në revista shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare

Numri i personelit akademik që shërbejnë në borde editoriale të revistave shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas njësive kryesore të UPT-së jepet në tabelën 15.

Tabela 15: Pjesëmarrje si anëtarë bordi editorial të personelit akademik sipas njësive kryesore, 2021-2022

PJESËMARRJE SI ANËTARË TË BORDIT EDITORIAL NË REVISTA SHKENCORE (KOMBËTARE & NDËRKOMBËTARE)		
NJËSIA KRYESORE	Revista Kombëtare	Revista Ndërkombëtare
FIN	2	2
FAU	1	5
FIMIF	0	7
FTI	1	2
FIE	2	1
FIM	3	20
FGJM	3	3
IGJEO	7	7
TOTALI UPT	19	47

Siç shihet qartë nga tabela 15, një numër më të lartë të pjesëmarrjes të personelit akademik të njësive kryesore në UPT e ndeshim në bordet editoriale të revistave ndërkombëtare.

FIM ka numrin më të lartë të personelit akademik si pjesëmarrës në borde editoriale të revistave ndërkombëtare.




Figura 18: Numri i personelit akademik që shërbejnë në borde editoriale të revistave shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas njësive kryesore.

Ndër revistat kombëtare në të cilat është angazhuar personeli akademik i UPT-së, mund të përmendim:

- Buletini i Shkencave Teknike të Universitetit Politeknik të Tiranës,
- Albanian Journal of Natural and Technical Sciences, Akademia e Shkencave e Shqipërisë,
- Buletini i Shkencave Gjeologjike ISSN 0254-5276,
- Buletini klimatik mujor (Janar 2018- aktualisht) ISSN: 2521-831X,
- Recesente e revistes Albanian Journal of Natural and Technical Sciences,
- Recesente e Revistes_OMB Observatory of the Mediterranean Basin,
- JNTS ISSN: 2074-0867,

Lista e revistave ndërkombëtare në të cilat stafi akademik është angazhuar është më e gjerë:

- Arhitektura i urbanizam,
- South East European Journal of Architecture and Design (SEEJAD),
- JAS – SUT. Journal of Applied Sciences-SUT. Publisher,
- Journal of Civil Engineering and Architecture, USA,
- Journal of Advances in Medicine and Medical Research,
- Asian Journal of Physical and Chemical Sciences Asian,
- Journal of Research and Review in Physics,
- Journal of mathematics and statistics,
- Journal of advanced studies in topology,
- International journal of algebra and statistics,
- Annals of applied sciences,
- International Journal of Ecosystems and Ecology Science (IJEES),
- International Journal of Innovative Technology and Interdisciplinary Sciences (IJITIS),
- Editorial Board Member: “Journal of Energy and Natural Resources (JENR),
- Editorial Board Member: “American Journal of Mechanical and Industrial Engineering (AJMIE),
- Textile & Leather Review,
- Tekstilec,
- Journal of International Engineering and Natural Science,
- International Journal of Science and Technology ISSN: 2654-4113,
- International Journal of Mechanical Engineering and Applications ISSN: 2330-0248,
- Journal of Multidisciplinary Engineering Science and Technology ISSN: 2458-9403,
- International Journal of Innovative Technology and Interdisciplinary Sciences ISSN: 2613-7305,
- American Journal of Engineering Research and Reviews ISSN:2637-3785,

- International Research Journal of Optics and Photonics ISSN:2637-6881,
- International Research Journal of Materials Sciences and Applications ISSN:2575-1034,
- International Journal of Nanoparticle Research ISSN:2637-6393,
- Scientific and Technical Journal in Technology and Design in Electronic Equipment ISSN:2309-9992,
- International Conference on Computational and Experimental Science and Engineering,
- International Journal of Innovative Technology and Interdisciplinary Sciences (IJITIS) ISSN:2613-7305,
- International Journal of Intelligent Systems and Applications in Engineering (IJISAE) ISSN: 2147-6799
- Journal of Technology Innovations in Renewable Energy ISSN: 1929-6002,
- Journal of Geography and Geology ISSN(Print): 1916-9779 ISSN(Online): 1916-9787,
- WASET Scientific and Technical Committee,
- Environment and Ecology Research ISSN: 2331-6268) is indexed by Scopus,
- Frontiers in Plant SciencePlant Nutrition ,
- Journal of Experimental Agriculture International,
- Environment and Ecology Research Roli: Review editor 03/2021 ISSN: 2673-4524,
- Frontiers in Sustainability; Roli: Guest Associate Editor ISSN: 2673-4524,
- Princeton GFDL Roli: REVIEWER ICTP News Roli: REVIEWER ISSN: 0149-9270; ISSN: 2222-6923.

Në tabelën 16 jepet krahasimi i pjesëmarrjes së personelit akademik në borde editoriale të revistave shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas njësive kryesore, në dy vitet e fundit, 2020-2021, 2021-2022.

Tabela 16: Krahasimi i shpërndarjes së personelit akademik në borde editoriale të revistave shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas njësive kryesore, në dy vitet e fundit, 2020-2021, 2021-2022.

NJËSIA KRYESORE	VITI 2020-2021			VITI 2021-2022		
	Revista Kombëtare	Revista Ndërkombëtare	TOTAL 2020- 2021	Revista Kombëtare	Revista Ndërkombëtare	TOTAL 2021- 2022
FIN	1	1	2	2	2	4
FAU	1	3	4	1	5	6
FIMIF	1	3	4	0	7	7
FTI	1	2	3	1	2	3
FIE	1	0	1	2	1	3
FIM	2	27	29	3	20	23
FGJM	2	1	3	3	3	6
IGJEO	7	4	11	7	7	14
TOTALI UPT	16	41	57	19	47	66

7. Çmime kombëtare/ndërkombëtare për punën kërkimore shkencore, patenta të regjistruara brenda ose jashtë vendit

Gjatë vitit akademik 2021-2022 nuk është fituar asnjë çmimi kombëtar ose ndërkombëtar nga personeli akademik i UPT-së.

8. Bashkëpunime me Sektorin e Prodhimit

Bashkëpunimi me sektorin e prodhimit është realizuar nga njësitë kryesore: FIE, FIM, FGJM dhe IGJEO në fushat dhe me rezultatet e mëposhtme, Tabela 17.

Tabela Nr. 17: Bashkëpunime me sektorin e prodhimit sipas njësive kryesore

BASHKËPUNIME ME SEKTORIN E PRODHIMIT			
NJËSIA KRYESORE	LLOJI I BASHKËPUNIMIT	FUSHA KU OPERON	REZULTATI
FIE	Support to DPS in aligning legislation and work procedures with the EU acquis and CEN-CENELEC criteria, aiming to prepare DPS to become full member of CEN-CENELEC	DPS- Adaptimi i standardeve ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë	Rishikoni strukturën aktuale të TI-së në DPS. Analiza e menaxhimit ekzistues të standardeve në DPS.
	Oponence e Kodit të Transmetimit në kuadër të konsultimit nga ERE	ERE	Oponenca
FIM	Kontrate bashkëpunimi shkencor Ministria e Infrastruktura dhe Energji	Efienca e Energji AKBN	
	Konsulenca AKBN:	<i>Vlerësimi i Projektimit të Detajuar të Gazsjellësit Fier – Vlorë</i> me objekt <i>“Mbështetje për Burimet Natyrore”</i> të financuar nga investimet strategjike <i>“Western Balkans Investment Framework (WBIF)</i>	
FGJM	Oponencë Teknike Vlerësimi i Projektimit të Detajuar të Gazsjellësit Fier – Vlorë – AKBN (në kuadër të “Ftesë për Ekspert në Projektet “Mbështetje për Burimet Natyrore (Kërkim – Zhvillim)”, Nr.2 i Protokollit AKBN, datë 01.06.2022”	AKBN	Njohja me projektet infrastrukturore që pritet të zhvillohen lidhur me gazifikimin e vendit
IGJEO	Raporte e relacione për të tretë për kompani, ministri, gjykata, projekte, etj.	Në ndërtim, bujqësi, energjetikë, transport, turizëm, media etj.	Të ardhura për institutin.

9. Kontributi institucional

Përfshirja e personelit akademik në aktivitete në mbështetje të Institucionit është dhënë në tabelën 18.

Tabela 18: Përfshirja e personelit akademik në aktivitete në mbështetje të Institucionit

KONTRIBUTI INSTITUCIONAL					
NJËSIA KRYESORE	KP	KPPA	Pjesëmarrje në grupe pune	Pjesëmarrje në juri në Doktoratë	Pjesëmarrje në juri në KPPA
FIN	0	0	0	0	0
FAU	4	1	24	21	5
FIMIF	5	1	3	18	10
FTI	0	0	13	0	0
FIE	4	2	12	1	1
FIM	5	1	8	0	0
FGJM	7	1	17	21	2
IGJEO	0	0	4	0	0
TOTAL	25	6	81	61	18

Përfshirjen më të lartë të personelit akademik në aktivitete në mbështetje të institucionit, e zë aktiviteti “Pjesëmarrje në grupe pune”.

10. Aktivitete të tjera

Në tabelën 19 jepet informacion për pjesëmarrjen e personelit akademik në aktivitete të tjera.

Tabela 19: Aktivitete të tjera në të cilat është përfshirë personeli akademik në nivel Institucioni

EMËRTIMI I AKTIVITETIT	NUMRI I AKTIVITETEVE	NUMRI I PJESËMARRËSVE NË AKTIVITETE
Studime Shkencore	3	3
Pjesëmarrje në grupe kërkimore shkencore dhe rrjete shkencore	19	26
Udhëheqje Doktorate	36	36




Figura 19: Shpërndarja e numrit të pjesëmarrësve në aktivitete të tjera sipas njësive kryesore

11. Infrastruktura në shërbim të Kërkimit Shkencor

UPT ka në përdorim laboratorë, të cilët u shërbejnë nevojave të procesit mësimor dhe atij kërkimor shkencor të njësive bazë. Institucioni kujdeset për plotësimin dhe rinovimin e pajisjeve laboratorike, dhe të pajisjeve didaktike dhe kompjuterikë. Në tabelën 20 janë dhënë në mënyrë të detajuar laboratorët, që mbështesin punën kërkimore shkencore në UPT sipas fakulteteve.

Tabela 20: Laboratorët shkencorë sipas fakulteteve

NJËSIA KRYESORE	EMRI I LABORATORIT	MBËSHTET
FIN	Laboratori i Gjroteknikës	Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi e Inxhinieri Hidroteknike, Master i Shkencave Inxhinieri Ndërtimi të gjitha profilet
	Laboratori i Rrugëve	Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi, Master i Shkencave Inxhinieri Ndërtimi Profili Transport
	Laboratori i Materialeve të Ndërtimit	Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi, Inxhinieri Hidroteknike, Master i Shkencave Inxhinieri Ndërtimi të gjitha profilet
	Laboratori i Hidraulikes	Bachelor ne Hidroteknike, Bachelor ne Ndertim; Bachelor ne Inxhinieri Mekanike, Bachelor ne Gjeomjedis.
FAU	CAAD	MSHA-Profil Arkitekt
		MSHA-Profil Urbanist
		BAIND
	Laborator i Lendeve te projektimit ambiental	MSHA-Profil Arkitekt
		MSHA-Profil Urbanist
		BAIND
	Laborator i Restaurimit	MSHA-Profil Arkitekt
		MSHA-Profil Urbanist
		Mp. Restaurim Monumentesh Kulture.

FIMIF	Laboratori i Informatikes 1	BCH
	Pajisja “EHP-50”, për matjen e fushës elektromagnetike në brezin e frekuencave të ulëta 1-400kHz	MP, MSH në Inxhinieri Fizike
	Pajisja “SRM-3006 Selective Radiation Meter” për matjen e fushës elektromagnetike në brezin e frekuencave të larta 9 kHz to 6 GHz.	Kërkim Shkencor dhe MSH
	DSC 250: Differencial Scanning Colorimetr	PhD, MSH
	Laboratori i DK	Lenden e kimise ne programet e studimit te inxhinierise ne UPT.
	Japanese Language laboratory	Të gjitha programet Bachelor të UPT që kanë laboratorin e kimisë si pjesë të kurrikulës së tyre
FTI	Laboratori i Telekomunikacionit, Sistemeve të sigurisë dhe Sistemeve të Informacionit	Master i Shkencave Inxhinieri Elektronike, Master i Shkencave Inxhinieri Telekomunikacioni
	Laboratori Multimedial dhe Sistemet e Rindertimit 3D	Master i Shkencave Inxhinieri Elektronike Master i Shkencave Inxhinieri Telekomunikacioni
	Laboratori i Radiofrekuencës dhe Komunikimeve Optike	Master i Shkencave Inxhinieri Elektronike Master i Shkencave Inxhinieri Telekomunikacioni
	Laboratori Embedded systems	Bachelor Inxhinieri Elektronike
		Bachelor Inxhinieri Telekomunikacioni
Bachelor Inxhinieri Informatike		
Laborator ne funksion te Programeve Master i Shkencave dhe Doktorature ne Inxhinieri Informatike.	Master i Shkencave dhe Doktorature ne Inxhinieri Informatike.	
FIE	Laboratori i Makinave Elektrike	Bachelor, Master, Doktorature
	Laboratori i Matjeve Elektrike	Bachelor, Master, Doktorature
	Laboratori i Transmisioneve Elektrike	Bachelor, Master, Doktorature
	Laboratori i Automatikës	Bachelor, Master, Doktorature
	Laboratori i Elektroteknikës	Bachelor, Master
	Laboratori i Elektroteknikës së përgjithsme	Bachelor, Master
	Laboratori i Analizes se Sistemit Elektroenergjetik	Bachelor, Master, Doktorature
	Laboratori i Tensioneve te Larta dhe Materialeve Elektrike	Bachelor, Master, Doktorature
	Laboratori i Impianteve Elektrike dhe Mbrojtjes Rele	Bachelor, Master, Doktorature
FIM	Laboratori i termofluideve dinamike	Oleo dinamika dhe makinat hidraulike
	Laboratori i MDB	Konstruksione MDB
	Laboratori i Fizikes Teknike	Fizike Teknike
	Laboratori i lodhjes se detaleve	Elemente Makinash, Mekanike thyerje
	Laboratori i karakteristikave mekanike	Shkence konstruksione
	Laboratori i grafikes inxhinierike	Cad dhe vizatim teknik
	Laboratori i Metrologjise Mekanike	Bachelor ne Inxhinieri Mekanike, Inxhinieri Materiale, Master i shkencave ne Inxhinieri Ekonomike
	Laboratori i Teknologjise Mekanike	Bachelor ne Inxhinieri Mekanike, Inxhinieri Ekonomike, Inxhinieri Mekatronike
	Laboratori i CAD-CAM	Bachelor ne Inxhinieri Mekanike, Inxhinieri Ekonomike, Master i shkencave ne Inxhinieri Ekonomike, Master i shkencave ne Inxhinieri Mekanike, profili Prodhim dhe Menaxhim Industrial
	Laboratori i Materialeve	Bachelor ne Inxhinieri Mekanike, Inxhinieri Materiale, Master i shkencave dhe profesional ne inxhinieri materiale, Master i shkencave ne Inxhinieri Mekanike, profili Prodhim dhe Menaxhim Industrial

	Laboratori i AutoCAD	Bachelor ne Inxhinieri Mekanike, Inxhinieri Materiale, Inxhinieri Ekonomike, Inxhinieri Elektrike, Inxhinieri Mekatronike, Inxhinieri Gjeodezi, Gjeomjedis, Master i shkencave ne Inxhinieri Ekonomike, Master i shkencave ne Inxhinieri Mekanike, profili Prodhim dhe Menaxhim Industrial
	Laboratori i Reverse Engineering dhe Rapid Prototyping	Master i shkencave ne Inxhinieri Ekonomike, Master i shkencave ne Inxhinieri Mekanike, profili Prodhim dhe Menaxhim Industrial
	Laboratori Fiziko – Mekanik dhe Kimik i Tekstilit,	Strukture Tekstileshe, Teknologji Industriale I, II, II, Materiale Fibrore, Teknologjia e prodhimit te veshjeve, Permbarim dhe ngjyrim, Kimia e fibrave tekstile.
FGJM	Laboratori i Paleontologjise	Bach. inxhi. Gjeologjike
	Laboratori i Gjeokimise dhe Gjeomjedisit	Bach. inxhi. Gjeologjike+Bach.inxh gjeomjedis
	Laboratori i Shliffeve dhe Aneshliffeve	Bach. inxhi. Gjeologjike
	Laboratori i Mineralogjise	Bachelor në Inxhinieri Gjeologjike; Inxhinieri Gjeomjedisi; Inxhinieri Gjeoinformatike
	Laboratori i Petrografise	Bachelor në Inxhinieri Gjeologjike; Inxhinieri Gjeoinformatike
	Laboratori i Elektrometrisë	Bachelor në Inxhinieri Gjeologjike Master Shkencor Gjeofizike
	Laboratori i Sizmikës	Bachelor në Inxhinieri Gjeologjike Master Shkencor Gjeofizike
	Mekanikës së Shkëmbit dhe ndërtimit të punimeve	B-IBM, MP-Gjeomatike, MP-Miniera, MP-Gjeologji e zbatuar
	GIS dhe Modelimeve Minerare	B-IBM, MP-Gjeomatike, MP-Gjeomjedisi, MP-Gjeomatike, MP-Gjeoinformatike,
	Matjeve Topografike	B-IBM, MP-Gjeomatike, MP-Miniera,
	Përpunimit të mekanik të mineraleve	B-IBM, MP-Gjeomjedisi, B-InxhGjeologjike, B-Gjeoinformatike
	Flotimit dhe ç'ujëzimit	B-IBM, MP-Gjeomjedisi, B-InxhGjeologjike, B-Gjeoinformatike
	Laboratori i gjeologjisë inxhinierike dhe hidrogeologjisë	MSH+MP gjeologji inxhinierike
	Laboratori i gjeoinformatikës	Bach. Inxhi.informatike
	Laboratori PVT	Bach. Inxh. Naftë e gaz, MSH+MP Inxh. Naftë e gaz,
	Laboratori i Modelimit të Burimeve të Energjisë	Bach. Inxh. Naftë e gaz, MSH+MP Inxh. Naftë e gaz,
	Laboratori i MVSH	Bach. Inxh. Naftë e gaz, MSH+MP Inxh. Naftë e gaz
	Laboratori i Mekanikës së Fluideve	Bach. Inxh. Naftë e gaz, MSH+MP Inxh. Naftë e gaz
	Laboratorit i Lëngjeve Larës dhe Fluideve Teknologjike	Bach. Inxh. Naftë e gaz, MSH+MP Inxh. Naftë e gaz
IGJEO	SKMM	Meteorologji
	Laboratori sizmologjik:	Studentët dhe supervizorët nga stafi ynë akademik kanë përdorur të dhënat dhe programet që disponojnë.
	- Sistemi dixhital regjistrues	
	GBV – 316	
	- Sistemi dixhital për matje	
	sizmike fushore	
	- Data logger	
	- Regjistrues Sizmologjik	
Portativ		

- GURALP CMG-5TD
- Sizmometri i tipit SS-1 ose
Ranger
- Sistem për regjistrimin e
lëkundjeve të forta
- Sistem dixhital për
regjistrimin e lëkundjeve të
dobëta
- Sizmometer bandëgjërë
(BB)
- Marresat GPS te tipit
Ashtech MicroZ CGRS
dhe Ashtech Z-Extreme

Fakulteti i Inxhinierisë Matematikë dhe Inxhinierisë Fizike




Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit



Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit





Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës



Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike




Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike





Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minerave



Instituti i Gjeoshkencave



12. Biblioteka shkencore

Biblioteka Shkencore e UPT është një strukturë në mbështetje të kërkimit shkencor, pasi grumbullon dhe ruan të gjithë trashëgiminë kërkimore shkencore të shkruar të personelit akademik e kërkimor të UPT-së, si edhe personelit kërkimor të Institutit të kërkim zhvillimit, të botuara brenda dhe jashtë vendit.

Kjo bibliotekë, e pozicionuar pranë UPT-së, ka pjesë përbërëse të strukturës së saj: Bibliotekën e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, Bibliotekën e Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave, si dhe Bibliotekën e Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, të cilat funksionojnë si degë të saj. Biblioteka plotëson nevojat studimore dhe shkencore të të gjithë njësive kryesore të UPT-së. Koleksionet e këtyre të fundit, përbëjnë sipas kushteve të çdo njësie kryesore ose të përdoruesve, fonde librash dhe periodikësh për të krijuar degë/biblioteka sa më pranë studentëve, stafit akademik, kërkuesve, etj.

Në figurën 20 dhe në figurën 21 jepet pasurimi i Bibliotekës Shkencore me literaturë, për vitet 2021 dhe 2022.

Tabela 21: Numri total i titujve të rinj / sasia e tyre në copë, për vitin 2021.

TITUJ TE RINJ NË BIBLIO TEKAT SHKENCORE TE UPT, 2021															
Nr.	EMËRTIMI	GJITHSEJ		NGA KËTO :											
		NJËSI	TITUJ	BIBLIO TEKA SHKENCORE		DEGË TË BIBLIO TEKËS SHKENCORE									
				QENDËR		BIBLIO TEKA FIN		BIBLIO TEKA FGJM		BIBLIO TEKA FIMIF		BIBLIO TEKA IGJEO		BIBLIO TEKA FIE&FII	
				Sasi	Tituj	Sasi	Tituj	Sasi	Tituj	Sasi	Tituj	Sasi	Tituj	Sasi	Tituj
Σ	LITERATURA GJITHSEJ (I + II)	259	165	125	77	36	9	32	18	-	-			66	61
I	LIBRA GJITHSEJ A+ B <i>Gjuhë Shqipe & Gjuhë të Huaj</i>	151	136	65	61	10	6	15	13	-	-			61	56
A	LIBRA NË GJUHËN SHQIPE	63	55	37	34	1	1	5	3	-	-			20	17
B	LIBRA NË GJUHË TË HUAJ	88	81	28	27	9	5	10	10	-	-			41	39
II	PERIODIK GJITHSEJ A+ B <i>Gjuhë Shqipe & Gjuhë të Huaj</i>	108	29	60	16	26	3	17	5	-	-			5	5
A	PERIODIK NË GJUHËN SHQIPE	6	4	1	1	1	1	3	1	-	-			1	1
B	PERIODIK NË GJUHË TË HUAJ	102	25	59	15	25	2	14	4	-	-			4	4

Tabela 22: Numri total i titujve të rinj / sasia e tyre në copë, për vitin 2022.

TITUJ TE RINJ NË BIBLIO TEKAT SHKENCORE TE UPT, 2022															
Nr.	EMËRTIMI	GJITHSEJ		NGA KËTO :											
		NJËSI	TITUJ	BIBLIO TEKA SHKENCORE		DEGË TË BIBLIO TEKËS SHKENCORE									
				QENDËR		BIBLIO TEKA FIN		BIBLIO TEKA FGJM		BIBLIO TEKA FIMIF		BIBLIO TEKA IGJEO		BIBLIO TEKA FIE&FII	
				Sasi	Tituj	Sasi	Tituj	Sasi	Tituj	Sasi	Tituj	Sasi	Tituj	Sasi	Tituj
Σ	LITERATURA GJITHSEJ (I + II)	1230	434	820	253	178	57	148	42			38	38	46	44
I	LIBRA GJITHSEJ A+ B <i>Gjuhë Shqipe & Gjuhë të Huaj</i>	1085	369	748	239	169	55	127	36	-	-	2	2	39	37
A	LIBRA NË GJUHËN SHQIPE	828	168	611	130	107	12	94	12	-	-	2	2	14	12
B	LIBRA NË GJUHË TË HUAJ	257	201	137	109	62	43	33	24	-	-	-	-	25	25
II	PERIODIK GJITHSEJ A+ B <i>Gjuhë Shqipe & Gjuhë të Huaj</i>	145	65	72	14	9	2	21	6	-	-	36	36	7	7
A	PERIODIK NË GJUHËN SHQIPE	32	28	1	1	-	-	6	2	-	-	24	24	1	1
B	PERIODIK NË GJUHË TË HUAJ	113	37	71	13	9	2	15	4	-	-	12	12	6	6

Shërbimet teknike si pasurimi me literature të re dhe përpunimi standard i tyre, krijohen nga kjo bibliotekë. Veprimtari të tjera të Bibliotekës Shkencore kanë konsistuar në: Përgatitjen dhe shpërndarjen e informacionit bibliotekar dhe bibliografik; Krijimin dhe mirëmbajtjen e katalogut përmbledhës të pasurisë bibliotekare kombëtare dhe asaj të huaj; Sigurimin nëpërmjet marrëdhënieve të shkëmbimit ndër fushat e shkencave teknike që nuk mund të mundësohen nëpërmjet blerjes me fondet buxhetore, etj.

13. Ndërkombëtarizimi në UPT

Universiteti Politeknik i Tiranës, bazuar në referencat ligjore, si: Ligji "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe në dokumentat e tij themelore, si Statuti, Plani Strategjik, rregullore të UPT - së etj, synon të bëhet një qendër e rëndësishme dhe pikë referimi kombëtare e rajonale në kooperimin akademik universitar, kërkimin shkencor, aktivitetin botues dhe promovimin e vlerave zhvilluese e qytetare të arsimit të lartë.

UPT synon të zgjerojë aktivitetin e rrjeteve dhe strukturave të organizuara institucionale universitare, në kuadrin e rajonit të Europës Jug-Lindore, vendeve të Bashkimit Europian e më gjerë. Ai synon përfshirjen në sa më shumë projekte europiane të arsimit të lartë, në interes të zhvillimit të stafit akademik, mobilitetit të pedagogëve dhe studentëve, si dhe të aplikimit të standardeve europiane të cilësisë. UPT, duke vlerësuar mundësitë që ofron ndërkombëtarizimi, përpiqet të realizojë politikat e bashkëpunimit me partnerë të besueshëm kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

a. Marrëveshjet ndër-institucionale të UPT-së

Në kornizën e bashkëpunimit, si aktorë bashkëpunues ndërkombëtarë, parashikohen kryesisht institucione homologe rajonale, europiane e më gjerë.

Universiteti Politeknik i Tiranës, njësitë kryesore dhe njësitë bazë të tij, planifikojnë dhe organizojnë në mënyrë të vazhdueshme veprimtari në fushën e bashkëpunimit me palët e interesuara, marrëveshje dhe projekte të përbashkëta, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, në koordinim institucional duke përfshirë të gjitha strukturat dhe organet e UPT-së.

Gjatë vitit akademik 2021-2022, UPT ka bashkëpunuar me një numër të konsiderueshëm institucioneesh, brenda dhe jashtë vendit. Në kuadër të këtij bashkëpunimi janë realizuar:

- Marrëveshje të UPT me institucione publike brenda vendit: 22
- Marrëveshje me universitete brenda vendit: 18

- Marrëveshje me kompani dhe biznese brenda vendit: 92
- Marrëveshje me universitete të huaja: 66
- Marrëveshje me universitete të huaja në kuadër të Erasmus+: 50

Krahasimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit për vitet akademike 2020-2021 dhe 2021-2022 është dhënë në figurën 20.




Figura 20: Krahasimi i numrit të marrëveshjeve të bashkëpunimit në dy vitet e fundit.

Siç shihet nga figura 20 kemi një rritje të numrit të marrëveshjeve të bashkëpunimit të UPT gjatë vitit akademik 2021-2022, duke e krahasuar me vitin e mëparshëm akademik 2020-2021.

b. Mobilitetet e personelit akademik dhe administrativ si dhe të studentëve të UPT-së

UPT ka vënë në dispozicion të bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar kohën dhe organizmat e nevojshme për shkëmbimet e personelit akademik, administrativ dhe për studentët e institucionit, si dhe mbështetjen përkatëse financiare.

Gjatë vitit akademik 2021-2022, janë realizuar:

- 108 Mobilitete stafi, nga të cilët 69 outgoing dhe 39 incoming,
- 85 Mobilitete studentësh, nga të cilët 66 outgoing dhe 19 incoming.




Figura 21: Mobilitetet Outgoing dhe Incoming të personelit akademik dhe studentëve sipas njësive kryesore, viti 2021-2022.

Tabela 23: Numri i Stafit Outgoing sipas Universiteteve

Nr.	Emërtimi i Universiteti	Numri i stafit
1	Universiteti West Attica, Greqi	6
2	Nysa, Poloni	4
3	Liberez, Ceki	3
4	Gheorge Asaki, Rumani	3
5	Istanbul Technical University	1
6	Unitrento, Itali	2
7	AGH, Poloni	10
8	Tuscia, Itali	3
9	On Dokuz Mayıs, Turqi	4
10	Viseu, Portugali	8
11	Bari, Itali	21
12	A Coruna, spanje	3
13	Milano, Itali	1

Personel akademik për mësimdhënien nga UPT në Universitetet jashtë vendit janë 28.

Personel akademik për trainim nga UPT në Universitetet jashtë vendit janë 41.

Vihet re gjithashtu, risia e praktikës së ardhjes së personelit akademik të universiteteve të tjera të huaja në UPT për mësimdhënie dhe trainim, ku krahasuar me një vit akademik më parë ku e ndeshim inekzistent, si në nivel njësie kryesore ashtu edhe në nivel institucioni.

Tabela 24: Numri i Stafit të ardhur nga Universitetet jashtë vendit në UPT, sipas Universiteteve, viti akademik 2021-2022

Nr.	Universiteti	Numri i stafit
1	AGH, Poloni	10
2	West Attica, Greqi	10

3	Istanbul Technical University	4
4	Liberez, Ceki	2
5	Bari Itali	2
6	UTC Francë	3
7	Riga, Letoni	3
8	ELTE, Hungari	1
9	Salento, Itali	1
10	Chietti, Itali	1
11	On Dokuz mayis, Turqi	1
12	ISCTE, Portugali	1

Personel akademik për mësimdhënien në UPT nga Universitetet jashtë vendit janë 10.

Personel akademik për trainim në UPT nga Universitetet jashtë vendit janë 29.

FAKULTETET	VITI 2020-2021		VITI 2021-2022	
	Outgoing	Incoming	Outgoing	Incoming
FIN				▲ 2
FAU	2		▲ 21	▲ 2
FIMIF			▲ 11	
FTI			▲ 11	
FIE			▲ 3	▲ 3
FIM			▲ 13	▲ 2
FGJM			▲ 2	▲ 1
Personel administrativ UPT			▲ 8	▲ 29
TOTALI UPT	2	0	▲ 69	▲ 39

Figura 22: Krahasimi i numrit të mobiliteteve Outgoing dhe Incoming të personelit akademik dhe administrativ sipas njësive kryesore, në dy vitet e fundit, 2020-2021 dhe 2021-2022.

Për sa i përket mobiliteteve të stafit akademik të UPT-së drejt universiteteve të tjera, vihet re një rritje e madhe e këtij numri, nga 2 në vitin akademik 2020-2021 në 69 për vitin akademik 2021-2022, si në nivel njësie kryesore ashtu edhe në nivel institucioni. Kufizimi i mobiliteteve për vitin akademik 2020-2021 ka qenë dhe për arsye të situatës së pandemisë.

Vihet re gjithashtu, risia e praktikës së ardhjes së personelit akademik të universiteteve të tjera jashtë vendit si për mësimdhënie dhe për trainim në UPT, ku krahasuar me një vit akademik më parë ka qenë inekzistent, si në nivel njësie kryesore ashtu edhe në nivel institucioni.




Figura 23: Mobilitetet Outgoing dhe Incoming të studentëve sipas njësisive kryesore.

Universitetet jashtë vendit, në të cilat kanë shkuar studentët e UPT-së për të realizuar mobilitete në kuadër të Erasmus+ janë si më poshtë:

Tabela 25: Numri i studentëve Outgoing

Nr.	Emërtimi i Universiteti	Numri i studentëve
1	A CORUNA, Spanjë	5
2	POLITO, Itali	10
3	CHIETTI, Itali	5
4	NTNU, Norvegji	7
5	NYSA, Poloni	4
6	GEORGHE ASACHI, Rumani	1
7	IUAV, Itali	3
8	UNIGE, Itali	5
9	AHALD, Gjermani	4
10	UNITRENTO, Itali	1
11	WEST ATTICA, Greqi	2
12	AGH, Poloni	2
13	COMPIEGNE, Francë	2
14	RIGA, Letoni	1
15	UNIVERSITETI ZAGREB, Kroaci	2
16	POLIBA POLITECNICO BARI, Itali	12
	TOTAL	66

Universitetet jashtë vendit, nga të cilat kanë ardhur studentët për të realizuar mobilitetet e tyre në UPT janë dhënë në tabelën 26.

Tabela 26: Numri i studentëve Incoming

Nr.	Emërtimi i Universiteti	Numri i studentëve
1	UTC, Francë	15
2	ITU, Turqi	1
3	CHIETI, Itali	3








FAKULTETET	VITI 2020-2021		VITI 2021-2022	
	Outgoing	Incoming	Outgoing	Incoming
FIN		18		 15
FAU	18		 41	 4
FIMIF	1		1	
FTI	5		 7	
FIE	1		1	
FIM	11		 15	
FGJM	2		 1	
TOTALI UPT	38	18	 66	19

Figura 24: Krahasimi i numrit të mobiliteteve Outgoing dhe Incoming të studentëve sipas njësive kryesore, në dy vitet e fundit, 2020-2021 dhe 2021-2022

Për sa i përket mobiliteteve të studentëve të UPT-së drejt universiteteve të tjera, vihet re një rritje e këtij numri (pothuajse dy fishi), krahasuar me një vit akademik më parë, si në nivel njësie kryesore ashtu edhe në nivel institucioni.

Nuk vihen re diferenca në numrin e ardhjes së studentëve të universiteteve të tjera krahasuar me një vit akademik më parë ku e ndeshim inekzistent, si në nivel njësie kryesore ashtu edhe në nivel institucioni.

Lidhur me procedurat e kryerjes së mobiliteteve, stafi administrativ i Rektoratit të UPT-së, ndjek me kujdes mobilitetin e studentëve dhe të stafit, para, gjatë dhe pas mobilitetit.

Konkretisht, pas komunikimeve me universitetet partnere, bazuar në marrëveshjet IIA respektive, hapen dhe publikohen thirrjet në faqet zyrtare të univesitetit dhe të fakulteteve. Stafi administrativ i Rektoratit të UPT-së këshillon dhe orienton studentët dhe stafin e interesuar për plotësimin e

dokumentacionit të nevojshem dhe zbatimin e kriterëve para mobilitetit. Gjatë mobilitetit, stafi administrativ i Rektoratit të UPT-së mban kontakte të drejtpërdrejta me universitetet partnere dhe me studentët për ecurinë e mobilitetit, përzgjedhjen dhe zhvillimin e lëndëve, akomodimin, si dhe problematika të tjera. Pas mobilitetit, stafi administrativ i Rektoratit të UPT-së, në bashkëpunim me fakultetet respektive, kujdeset për njohjen dhe ekuivalentimin e lëndëve dhe plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm, të përcaktuar nga Erasmus dhe universitetet partnere.

c. Pjesëmarrje në rrjete akademike-shkencore

Gjatë vitit akademik 2021-2022, Universiteti Politeknik i Tiranës ka marrë pjesë si anëtar në rrjetet universitare si më poshtë:

- BSUN (Black Sea Universities Network),
- UNICA (Universities from Capitals of Europe),
- AUF (Agence Universitaire de la Francophonie),
- CUM (Communaute des Universites de la Mediteranee),
- The Magna Charta Universitatum,
- UNIMED (Mediterranean Universities Union).

IV. SHËRBIMET NDAJ TË TRETËVE

Në mbështetje të V.K.M-së nr. 188, datë 13.03.2019 “Për ofrimin nga institucionet publike të arsimit të lartë të shërbimeve, në përputhje me veprimtarinë e tyre, për institucionet e qeverisjes qendrore dhe institucionet në varësi të tyre”, Vendimit Nr.1055, datë 22.12.2010 të Këshillit të Ministrave “Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”, Ligjit Nr. 12/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, Ligjit Nr. 124/2015 “Për Eficiencën e Energjisë”, Ligjit Nr. 116/2016, “Për performancën e Energjisë së Ndërtesave”, Ligjit Nr.5/2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 124/2015 “Për Eficiencën e Energjisë”, VKM-së Nr.26, datë 15.01.2010, “Për kryerjen e aktekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara”, të “Rregullores për Disiplinimin e Sistemit të Shërbimeve në UPT”, miratuar me Vendimin Nr. 15, datë 24.04.2020, të Bordit të Administrimit, përgjatë periudhës Tetor 2021– Shtator 2022, pasqyrimet e shërbimeve të kryera, të ardhurat e arkëtuara, si dhe personeli akademik i angazhuar paraqiten si më poshtë:

Shërbime të realizuara:

- Nr. 210 - Oponenca teknike për veprat e ndërtimit.
- Nr. 22 – Hartim projektesh, studime, akt-ekspertiza etj.

Të ardhura të arkëtuara:

Nga realizimi i shërbimeve të kryera përgjatë periudhës 1 tetor 2021 deri më 30 shtator 2022, institucioni ka siguruar të ardhura në shumën 132,563,617 (njëqind e tridhjetë e dy milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e shtatëmbëdhjetë) lekë me tvsh. Ky total është shumatorë e vlerës prej 85,110,853 (tetëdhjetë e pesë milionë e njëqind e dhjetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e tre) lekë me tvsh për realizimin e oponencave teknike, si dhe vlerës prej 47,458,764 (dyzet e shtatë milionë e katërqind e pesëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë me tvsh për realizimin e hartimit të projekteve, studime, akt – ekspertiza etj. Vlerat për realizimin e shërbimeve sipërpërmendura janë kryer sipas parashikimeve të përcaktuara në VKM-në Nr.354, datë 11.05.2016, “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Personeli akademik i angazhuar:

Shërbimet e kryera në zbatim të V.K.M Nr. 188, datë 13.03.2019 janë shërbime në fushën e projektimit, të cilat përfshihen në fushat e ekspertizës së Universitetit Politeknik të Tiranës. Në kryerjen e shërbimeve të kësaj natyre janë angazhuar rreth 130 personel akademik, si dhe 20 studentë të fakulteteve të ndryshme.

Shërbimet për të tretët realizohen në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në kontratën/aktmarrëveshjen e shërbimit që lidhet ndërmjet Universitetit Politeknik të Tiranës dhe palëve të treta, mbështetur në legjislacionin në fuqi.

Kriteret profesionale që duhet të plotësojnë ekspertët pjesëmarrës në ofrimin e shërbimit përcaktohen, mbështetur në kërkesat e porositësit shprehur në dokumentacionin kontraktual, tipologjinë, fazat e shërbimit të porositura, si dhe çdo akt ligjor, nënligjor, apo normativ në fuqi, që rregullon tipologjinë e porositur të shërbimit dhe në varësi të shprehjes së interesit apo gadishmërisë nga ana e personelit akademik.

V. **AKTIVITETI I DREJTORISË SË KËRKIMIT SHKENCOR DHE PROJEKTEVE NË REKTORATIN E UPT-SË**

Drejtoria e Kërkimit Shkencor dhe Projekteve është strukturë e Rektoratit të Universitetit Politeknik të Tiranës e cila ka si mision mbështetjen e kërkimit shkencor në UPT, në përputhje të plotë me prioritetet strategjike dhe interesat e vendit, i cila gërshetohet me mësimdhënien me pikësynim rritjen e cilësisë së ofertës akademike.

Drejtoria e kërkimit shkencor dhe projekteve e realizon misionin e saj me anë të pjesëmarrjes e drejtpërdrejtë në administrimin e sistemit të burimeve të kërkimit shkencor në nivel institucional dhe mbështetjes funksionale të tij.

Drejtoria e kërkimit shkencor dhe projekteve në UPT siguron menaxhimin eficient të aktiviteteve kërkimore shkencore nëpërmjet nxitjes, bashkëpunimit, koordinimit dhe promovimit të formave të ndryshme të kërkimit shkencor e inovacionit në bashkëpunim të plotë me të gjitha njësitë kryesore dhe strukturat në UPT.

Aktiviteti i Drejtorisë së Kërkimit Shkencor dhe Projekteve gjatë vitit akademik Tetor 2021 deri në Tetor 2022 është zhvilluar konform Planit Strategjik të Universitetit Politeknik të Tiranës 2019-2024, në përputhje me misionin dhe principet e përgjithshme të kërkimit shkencor si dhe bazuar në objektivat afatmesme të zhvillimit të kërkimit shkencor në UPT.

Drejtimet kryesore të punës dhe veprimet për realizimin e sa më sipër si dhe rezultatet e arritura janë paraqitur në mënyrë sintetike në vazhdim:

➤ **Zhvillimi i një sistemi eficient të menaxhimit të aktiviteteve të kërkimit shkencor**

DKSHP është në mënyrë të vazhdueshme e interesuar në organizimin, përmirësimin dhe monitorimin eficient menaxhimit të aktiviteteve të kërkimit shkencor.

Për këtë qëllim, DKSHP veç njohjes dhe përditësimit me legjislacionin në fuqi dhe legjislacionin e UPT-së (në mënyrë të veçantë me “Rregulloren për fitimin e titujve akademikë”, “Rregulloren e Komisionit për promovimin e personelit akademik të Universitetit Politeknik të Tiranës”, “Rregulloren e Studimeve të Doktoratës së Universitetit Politeknik të Tiranës”, “Rregulloren e Komisionit të Përhershëm për dhënien e gradës shkencore “Doktor” e Universitetit Politeknik të Tiranës”, etj.), referues promovimit akademik dhe shkencor, mbështet politikën afatshkurtra të kërkimit shkencor dhe projekteve si dhe harton procedura ose materiale specifike në mbështetje të aktivitetit të kërkimit shkencor.

➤ **Procedura/materiale ndihmëse të hartuara**

Gjatë vitit akademik 2021-2022 janë hartuar këto procedura/materiale ndihmëse:

- a. “Procedura për aplikimin dhe pranimin në ciklin e tretë të studimeve ‘Doktoratë’ në Universitetin Politeknik të Tiranës”, e cila aplikohet për të orientuar dhe drejtuar DKSHP, njësitë kryesore, njësitë bazë të UPT-së si dhe kandidatët të cilët dëshirojnë të aplikojnë në studimet e Doktoratës dhe përshkruan etapat e organizimit të procesit të aplikimit, pranimit dhe përzgjedhjes së tyre në studimet e doktoratës në UPT.
- b. “Material ndihmës për procedurën e aplikimit për verifikim të kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore pas miratimit për hapjen/riorganizimin e programeve të studimit të ciklit të tretë për fitimin e grades shkencore ‘Doktor’”. Qëllimi i këtij materiali është të orientojë dhe mbështesë njësitë bazë/njësitë kryesore të UPT-së cilat kanë marrë aktin e hapjes/riorganizimit të programit të studimit të ciklit të tretë “Doktoratë” nga MAS, në vijim të plotësimit të dokumentacionit procedurës për verifikimin e kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore pas këtij akti.
- c. “Procedura për njohjen e ngarkesës mësimore për punën mbi hartimin dhe aplikimin në projektet e BE”, e cila gjen aplikim vetëm në hartimin dhe aplikimin e projekteve të financuara nga programet e Bashkimit Europian dhe aplikohet në aktivitetin akademiko-shkencor të çdo njësie bazë, çdo njësie kryesore dhe në nivel institucioni në përputhje me kërkesat specifike dhe legjislacionin në fuqi. Kjo procedurë përcakton mënyrën dhe rrugën operationale të ngritjes së grupit të punës për hartimin dhe aplikimin e projekteve të BE, dokumentacionit të nevojshëm për ngarkesën e pagueshme për përgatitjen e projektit nga grupi i punës si dhe siguron nivelin optimal të respektimit dhe përbushjes së kriterëve në njohjen e ngarkesës së pagueshme për hartimin dhe aplikimin e projekteve të BE.

➤ **Procedura/aktivitete të zbatuara**

Gjatë vitit akademik 2021-2022 janë zbatuar, mbështetur dhe monitoruar këto procedura/aktivitete:

- a. “Procedura operationale e verifikimit anti-plagjiaturë të Studimeve të Doktoratës”, cila aplikohet në aktivitetin akademik/shkencor të çdo fakulteti/departamenti të UPT-së në përputhje me kërkesat specifike dhe legjislacionin në fuqi. Kjo procedurë specifikon mënyrën dhe rrugën operationale të verifikimit të origjinalitetit dhe përputhshmërisë së punimeve të përfunduara të Studimeve të Doktoratës, sigurimin e nivelit optimal të origjinalitetit dhe përputhshmërisë të punimeve të përfunduara të Studimeve të Doktoratës si dhe sigurimin e vlerave etike dhe integritetit akademik/shkencor në studimet e doktoratës në UPT.

Në muajin Korrik të vitit 2022 u rinovua Memorandumi i Mirëkuptimit për Bashkëpunim të ndërsjellë midis UPT dhe Akademia Crossplag. Ky Memorandum ka për qëllim vënien në dispozicion të kandidatëve doktorantë të sistemit elektronik antiplagjiaturë, hartimin e ngritjen e treguesve të matshëm, mekanizmave të kontrollit për eliminimin e plagjiaturës dhe respektimin e të drejtës së pronësisë intelektuale në fushën e kërkimit shkencor, UPT.

Në kuadër të promovimit dhe mbështetjes institucionale të kërkimit shkencor si dhe personelit

akademik me kohë të plotë të UPT-së, si dhe me qëllim përmbushjen e politikave të mbështetjes financiare për doktorantët, është realizuar rimbursimi i tarifës së kontrollit antiplagjiaturë për personelin me kohë të plotë i UPT-së, i cili ka mbrojtur doktoratën në njësitë kryesore të UPT-së, dhe i është nënshtruar vlerësimit antiplagjiaturë gjatë periudhës 19.07.2021 e deri më tani, në platformën Akademia/Crossplag, Për këtë qëllim, DKSHP ka azhurnuar dhe kontrolluar në mënyrë të vazhduar listat emërore dhe dokumentacionim e studentëve të Doktoratës të 7 njësive kryesore të UPT-së.

b. “Procedura e regjistrimit së gradës shkencore në Regjistrin Shtetëror për gradën shkencore “Doktor” dhe në Regjistrin e UPT”, e cila aplikohet në përfundim të aktivitetit akademik/shkencor të ciklit të tretë të studimeve në çdo njësi kryesore dhe në nivel institucioni në përputhje me kërkesat specifike dhe legjislacionin në fuqi. Kjo procedurë përshkruan dhe përcakton etapat e organizimit të procesit të regjistrimit të gradës shkencore në Regjistrin shtetëror për gradën shkencore “Doktor” pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe shkencën si dhe të procesit të regjistrimit të gradës shkencore në Regjistrin e UPT-së.

c. DKSHP, për periudhën e raportimit, ka përgatitur e Raportet Teknike për programet e reja dhe riorganizimin e programeve të studimit të ciklit të tretë, të propozuara nga njësitë bazë të UPT. Gjithashtu, ka mbështetur me asistencë teknike-administrative në përgatitjen e dokumentacionit të nevojshme për aplikim për këto programe studimi të ciklit të tretë.

➤ **Përditësimi i bazës e të dhënave të kërkimit shkencor në UPT**

Një aktivitet tjetër i DKSHP është përditësimi i bazës e të dhënave të kërkimit shkencor në UPT, si të dhëna të standartizuara, lehtësisht të përdorshme, për një administrim sa më të mirë të kërkimit shkencor, në të cilat përfshihen:

- Disertacione të doktoratave të mbrojtura,
- Gradat Shkencore të fituara nga stafi akademik,
- Aktiviteti i kërkimit shkencor të personelit akademik e kërkimor të fakulteteve dhe të Institutit të Kërkim-Zhvillimit (IGJEO),
- Të dhëna sasiore dhe cilesore mbi pjesëmarrjen në Projektet e financuara, në kuadrin e programeve kombëtare dhe ndërkombëtare të kërkim – zhvillimit,
- Titujt akademike të fituar nga stafi akademik,
- Të dhëna mbi shpërndarjen e gradave shkencore dhe titujve akademikë në nivel Institucioni/njësie kryesore dhe njësie bazë,
- Të dhëna sasiore dhe cilesore mbi pjesëmarrjen në projekte kërkimore në nivel kombëtar si dhe projektet lokale të kërkim-zhvillimit,

- Të dhëna sasiore dhe cilesore mbi pjesëmarrjen në projekte të AKKSHI-t,
- Arkivat dhe koleksionet shkencore,
- Abonimet në revista apo botime shkencore periodike,
- Artikujt dhe autorët pjesëmarrës në Buletinin e shkencave Teknike të UPT-së,
- Programet e ciklit të tretë të studimeve “Doktoratë”, studentët të cilët i ndjekin, udhëheqësit e tyre, etj.

➤ **Ngritja e kapaciteteve të stafit të Drejtorisë së Kërkimit SHkencor dhe Projekteve**

Në kuadër të ngritjes/fuqizimit të kapaciteteve të stafit së DKSHP me qëllim përmirësimin e performancës së punës së DKSHP dhe mësimin nga praktikatat e mira të institucioneve të arsimit të lartë në Europë dhe më gjerë, gjatë vitit akademik 2021-2022 stafi i DKSHP ka qenë i përfshirë në mënyrë aktive në shumë projekteve ndërkombëtare si më poshtë vijon:

- REACH
- ENGINE
- BKSTONE
- DRIVE
- MARDS
- GRADUA

- ✓ Pjesëmarrje në projektin DRIVE: 2 dhe 3 Dhjetor 2021 – “Training workshop on research management”, Tiranë, Shqipëri
- ✓ Pjesëmarrje në projektin DRIVE: 11 dhe 12 Nëntor 2021 – “Training workshop on Teaching methodologies applied in the current study programmes; Action plan on RISS”, Aalborg, Daanimarkë.
- ✓ Pjesëmarrje në projektin DRIVE: 04 dhe 05 Prill 2022- Study Visit / Workshop, Hamburg University of Technology Institute of Business Logistics and General Management
- ✓ Pjesëmarrje në projektin MARSD: Tetor 2021 – “4th MARDS Consortium Meeting”, Shkodër Shqipëri

➤ **Promovimi i gradave shkencore në UPT**

1. Bazuar në strategjinë e UPT-së e cila ka në kuadër promovimin e arritjes dhe përmirësimit të kulturës së cilësisë në programet e studimit të ciklit të tretë, nëpërmjet reformimit dhe zbatimit të standardeve kombëtare dhe europiane, si dhe vlerësimit periodik e akreditimit, duke krijuar kështu premisa në fuqizimin dhe rritjen e nivelit shkencor të punës kërkimore të doktorantëve, DKSHP monitoron dhe mbështet zhvillimin e qëndrueshëm të studimeve të Doktoratës në çdo njësi kryesore/njësi bazë, duke iu referuar përvojës së institucioneve partnere të huaja si dhe duke u bazuar në kërkesat specifike të Institucionit/njësive kryesore/njësive bazë dhe legjislacionin në fuqi.

Gjatë vitit akademik 2021-2022, janë orientuar dhe mbështetur për hapje/riorganizim 5 programe studimi “Doktoratë”, si më poshtë vijon:

- Program studimi “Doktoratë” në Inxhinieri Matematike,
- Program studimi “Doktoratë” në Inxhinieri Fizike,
- Program studimi “Doktoratë” Inxhinieri Mekanike,
- Program studimi “Doktoratë” Inxhinieri e Burimeve Minerare,
- Program studimi “Doktoratë” me diplomë të dyfishtë midis UPT-së dhe Universita degli Studi di Firenze, “Qëndrueshmëria dhe inovacioni për projektin e mjedisit të ndërtuar dhe sistemit të produktit”.

DKSHP ka orientuar dhe mbështetur çdo aplikim gjatë përgatitjes së dokumentacionit dhe procesit të aplikimit duke realizuar kontrole/monitorim të materialeve të dosjeve të aplikimit si dhe duke hartuar raportet teknike për Grupet e Punës së Senatit Akademik të UPT-së, duke ofruar dhe specifikuar bazën ligjore të nevojshme si dhe duke lehtësuar të gjitha proceset administrative për një aplikim konform legjislacionit në fuqi.

Në zbatim të Urdhërave të MAS, Nr. 175, Nr. 176, Nr. 177, Nr. 178, Nr. 179, Nr. 180, Nr. 181, Nr. 182, Nr. 183, datë 4.4.2022, për hapjen e shkollave të doktoratës si më poshtë:

- a) Program studimi “Doktoratë” në fushën “Inxhinieri Elektrike”, me nënfushë “Automatizimi i Industrisë”
- b) Program studimi “Doktoratë” në fushën “Inxhinieri Elektrike”, me nënfushë “Energjetikë”
- c) Program studimi “Doktoratë” në “Fusha e konstruksioneve mekanike dhe vlerësimi i integritetit strukturor”
- d) Program studimi “Doktoratë” në fushën “Gjeologjia dhe mjedisi”
- e) Program studimi “Doktoratë” në “Inxhinieri naftë dhe gazi”
- f) Program studimi “Doktoratë” në fushën “Gjeodezi”, me nënfushë “Trajtim Imazhesh dhe Gjeodezi Fizike”
- g) Program studimi “Doktoratë” në fushën “Inxhinieri Fizike”, me nënfushë “Fizikë e Materialeve”
- h) Program studimi “Doktoratë” në fushën “Inxhinieri Ndërtimi”, me nënfushë “Inxhinieri Mjedisi”
- i) Program studimi “Doktoratë” në fushën “Teknologjitë e Informacionit dhe të Komunikimit”, me nënfusha “Telekomunikacion dhe Inxhinieri Informacioni” dhe “Inxhinieri Informatike”.

DKSHP, ka orientuar, mbështetur, monitoruar dhe lehtësuar punën e njërive kryesore, njërive bazë të UPT-së në procesin e aplikimit, pranimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve në studimet e doktoratës në UPT, nëpërmjet dërgimit të bazës ligjore në fuqi sipas specifikave, hartimit dhe dërgimit të procedurave dhe udhëzuesve të ndryshëm, kontrollit të dokumentacionit, etj.

Për sa më sipër, DKSHP ka përgatitur dhe mban evidenca dhe dokumentacion në përputhje me fushën e saj të veprimtarisë.

2. Në mbështetje të zhvillimit të qëndrueshëm të numrit të studentëve që ndjekin programet e studimit të ciklit të tretë në UPT, si një nga drejtimet kryesore të zgjerimit të veprimtarisë kërkimore shkencore, DKSHP ka në fokus promovimin, nxitjen dhe orientimin për marrjen e gradës shkencore “Doktor” për anëtarët e stafit akademik të UPT-së si dhe për anëtarët e personelit akademik të Universiteteve të tjera të vendit.

Gjatë vitit akademik 2021-2022 janë fituar 57 grada shkencore “Doktor” nga të cilat:

- a) 4 grada shkencore “Doktor” të dhëna nga Këshilli Profesorëve të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike,
 - b) 14 grada shkencore “Doktor” të dhëna nga Këshilli Profesorëve të Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave,
 - c) 18 grada shkencore “Doktor” të dhëna nga Këshilli Profesorëve të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit,
 - d) 7 grada shkencore “Doktor” të dhëna nga Këshilli Profesorëve të Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës,
 - e) 8 grada shkencore “Doktor” e dhënë nga Këshilli Profesorëve të Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike,
 - f) 4 grada shkencore “Doktor” e dhënë nga Këshilli Profesorëve të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit,
 - g) 2 grada shkencore “Doktor” e dhënë nga Këshilli Profesorëve të Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike.
3. Regjistrimi i gradave shkencore në Regjistrin Shtetëror për gradën shkencore “Doktor” dhe në Regjistrin e UPT-së

DKSHP pas plotësimit të kriterëve dhe procedurave përkatëse për dhënien e gradës shkencore, përgatit dhe përcjell pranë AKKSH-it dokumentet shoqëruese dhe kërkesën zyrtare për regjistrimin e gradës shkencore respektive në Regjistrin shtetëror për gradën shkencore “Doktor”.

Pas regjistrimit në Regjistrin shtetëror për gradën shkencore “Doktor” dhe në Regjistrin e UPT-së, lëshohet diploma e gradës shkencore “Doktor” sipas formatit të miratuar nga Senati Akademik i UPT-së.

Gjatë periudhës referuar raportimit, DKSHP ka kontrolluar dokumentacionin dosjeve të aplikimit për regjistrimin e gradës shkencore “Doktor” të kandidatëve doktorantë, të ardhura nga njësitë kryesore të

UPT-së dhe më pas ka përgatitur dokumentacionin e nevojshëm për regjistrimin e gradës shkencore “Doktor” në Regjistrin shtetëror për gradën shkencore “Doktor”, dhe ia ka përcjellë atë AKKSHIT:

- 59 dosje aplikimi për regjistrimin e gradës shkencore “Doktor” janë kontrolluar dhe më pas i janë përcjellë AKKSHI-t për regjistrimin e gradës shkencore “Doktor” në Regjistrin shtetëror për gradën shkencore “Doktor”,
- 57 grada shkencore “Doktor” janë regjistruar në Regjistrin shtetëror për gradën shkencore “Doktor” dhe në regjistrin e UPT-së.

Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe janë realizuar këto aktivitete:

- ✓ Janë zbatuar forma/metoda të realizimit të promovimit të Gradës shkencore “Doktor”, në përputhje me nevojat, kushtet dhe mundësitë institucionale, në bashkëpunim me njësitë kryesore/njësitë bazë të UPT-së.
- ✓ Është kërkuar dhe mbledhur informacion në lidhje me programet e studimit të ciklit të tretë të studimeve nga njësitë kryesore/njësitë bazë të UPT-së, në kuadër të raportimit mbi programet aktuale të studimit të ciklit të tretë si dhe promovimit të tyre.
- ✓ Është realizuar informimi dhe bashkëpunimi me komunitetin akademik, njësite kryesore/bazë, rreth mundësive të pjesëmarrjes në aktivitete/ programe të ndryshme të kërkimit shkencor.
- ✓ Janë marrë në dorëzim Dosjet se kandidatëve doktorantë nga njësia kryesore përkatëse dhe është kryer kontrolli i dokumentacionit të saj bazuar në legjislacionin në fuqi dhe sipas specifikave të AKKSHI-t.
- ✓ Janë përgatitur dhe përcjellë dokumentacionet e kandidatëve doktorantë, për regjistrim në “Regjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademike” pranë AKKSHI-t.
- ✓ Janë njoftuar kandidatët mbi kryerjen e regjistrimit së Gradës Shkencore "Doktor" pranë AKKSHI-t dhe janë përcjellë elektronikisht me e-mail dhe shkresë regjistrimet e Gradës Shkencore "Doktor" të AKKSHI-it.
- ✓ Janë kryer regjistrimit dhe administrimi i “Regjistrit të Doktoratave të UPT-së”.
- ✓ Janë përgatitur dhe janë dhënë Diplomat e gradës shkencore “Doktor”.
- ✓ Është kryer administrimi i dokumentacionit të gradave shkencore të depozituara në Drejtorinë e Kërkimit Shkencor dhe Projekteve.
- ✓ Është ngritur dhe përditësuar Data Base i doktorantëve të cilët kanë fituar gradën shkencore “Doktor”.
- ✓ Është bashkëpunuar në realizimin e analizave, raportimeve dhe buletineve informative, mbi aktivitetet e kërkimit shkencor.

- ✓ Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Neni 10 dhe Neni 78, Udhëzimit Nr. 6, datë 19.2.2018 “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit”; Udhëzimit Nr. 15, datë 22.6.2022, “Për një shtesë dhe një ndryshim në Udhëzimin Nr. 6, datë 19.2.2018 ‘Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit’”, DKSHP bashkëpunon aktivisht me QSHA duke dërguar periodikisht të dhënat arsimore të studentëve të pranuar në ciklin e tretë të studimeve “Doktoratë” për çdo vit akademik, si dhe duke ju përgjigjur kërkesave për verifikim të autenticitetit të diplomave të grades shkencore “Doktor”, dhe jo vetëm:
 - Janë vërtetuar për autenticitet të diplomës së gradës shkencore “Doktor”, 6 dokumenta.
 - Janë realizuar vizita pranë QSHA me qëllim bashkëpunimin aktiv në kuadër të përmbushjes së dërgimit të dokumentacionit të ndryshëm, sipas legjislacionit në fuqi.
- ✓ DKSHP është angazhuar në plotësimin e të dhënave të kërkuara nga grupi i auditimit të KLSH-së, duke plotësuar çështjet e lidhura me aktivitetin e kësaj drejtorie.
- ✓ Me qëllim përditësimit të bazës ligjore sipas fushës së veprimit, janë dërguar në njësitë kryesore të UPT-së në mënyrë periodike VKM, urdhëra dhe vendime.
- ✓ Në zbatim Udhëzimit Nr. 5, datë 19.02.2018 “Për përcaktimin e elementeve përbëse të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të Institucioneve të Arsimit të Lartë”, ndryshuar me Udhëzimin Nr. 24, datë 21.10.2011, DKSHP realizon çdo vit akademik:
 - Azhurnimin e formateve të raportimit të aktivitetit të kërkimit shkencor sipas Legjislacionit në fuqi.
 - Dërgimi i formateve të raportimit të aktivitetit të kërkimit shkencor në Njësitë Kryesore të UPT-së.
 - Mbështetja dhe monitorimi i procesit të plotësimit të raportimit të aktiviteteve të kërkimit shkencor nga Njësitë Kryesore të UPT-së.
 - Kontrolli i raporteve të aktivitetit të kërkimit shkencor të ardhura nga Njësitë Kryesore të UPT-së.
 - Mbledhje të dhënash dhe përpunim informacioni mbi aktivitetin kërkimor shkencor në nivel Institucioni.
 - Përgatitja e raportit vjetor të punës kërkimore shkencore në nivel Institucioni.

➤ **Organizimi dhe koordinimi i promovimit të titujve akademikë**

Promovimi i kërkimit shkencor në UPT ka një karakter dinamik, bazuar në një strategji të qëndrueshme për aktivitetin e stafit akademik-kërkimor, duke iu referuar të gjitha fazave të aktivitetit të tij dhe që konkludon në kualifikimin e vazhdueshëm dhe transmetimit të qëndrueshëm të experiencës.

UPT mbështet në mënyrë të vazhdueshme jo vetëm kualifikimin e vazhdueshëm të stafit të tij akademik por inkurajon dhe bën përpjekje, që të sigurojë bashkëpunim me institucione të tjera

homologe në vend, me qëllim ngritjen e kapaciteteve dhe aftësive shkencore-kërkimore të stafëve të tyre akademike duke kontribuar në promovimin e kërkimit shkencor në nivel kombëtar.

Organi përgjegjës për dhënien e titujve akademikë “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor” është Komisioni për Promovimin e Personelit Akademik (KPPA). Drejtori i Drejtorisë së Kërkimit Shkencor dhe Projekteve, për shkak të detyrës ex-officio është i emëruar si sekretar i KPPA dhe në mbështetje të procedurave dhe rregulloreve të këtij komisioni përgatit shkresat si edhe ndjek e kontrollon ecurinë e procedurave. Në këtë kuadër, gjatë periudhës së periudhës së raportimit, janë kryer këto aktivitete:

- a) Janë kontrolluar nga ana e plotësisë dokumentore sipas kërkesave të KPPA, dosjet e përcjella nga njësitë kryesore përkatëse të UPT-së si dhe nga drejtuesit e Universiteteve të huaja për kërkimin e titujve akademikë.
- b) Janë përgatitur shkresat përcjellëse të Kryetarit të Senatit Akademik drejtuar KPPA për përcjelljen e dosjeve.
- c) Janë përgatitur shkresat përcjellëse për miratimin e propozimit për përberjen e jurive nga Rektori i UPT-së drejtuar KPPA-së.
- d) Janë mbajtur dhe zbardhur provesverbalet e mbledhjeve të Komisionit si dhe vendimet e marra nga KPPA.
- e) Janë skanuar dokumentacionet e nevojshme të dosjeve për kërkimin e titujve akademikë.
- f) Janë përgatitur dhe mbajtur procesverbalet e tërheqjeve të dosjeve për arsye të ndryshme procedurale.
- g) Janë dërguar dosjet e plota, të skanuara, relatorëve si dhe jurive të vendosura nga KPPA.
- h) Janë përgatitur shkresat për regjistrimin për titujt akademikë në “Regjistrin Shtetëror të Titujve Akademike” drejtuar MAS-AKKSHI.
- i) Janë mbajtur dhe regjistruar në regjistrin e titujve akademikë titujt e fituar si dhe numrat e regjistrimit në MAS-AKKSHI.
- j) Janë përgatitur shkresat për njoftim, për regjistrimin dhe numrin e regjistrimit për titullin akademik pranë MAS-AKKSHI, për personelin akademik të UPT-së, drejtuar Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Juridike.
- g. Janë njoftuar kandidatët e Universiteteve të huaja për fitimin e titujve akademikë edhe për regjistrimin e titullit akademik pranë MAS-AKKSHI.
- h. Janë përgatitur Diplomat për titujt akademikë “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor”.

Gjatë vitit akademik 18 tetor 2021 - 14 tetor 2022 janë realizuar 11 mbledhje për shqyrtime të dosjeve për fitimin e titujve akademikë në të cilat janë shqyrtuar 31 dosje prej të cilave, 12 e kanë kaluar pozitivisht procesin e vlerësimit, kurse 5 prej tyre nuk i kanë përmbushur kriteret e vlerësimit.

- KPPA ka dhënë 4 tituj “Profesor” në total: 2 tituj “Profesor” i janë dhënë anëtarëve të stafit akademik të UPT-së dhe 1 titull “Profesor” i është dhënë një anëtar të stafit akademik të Universitetit Epoka dhe 1 titull “Profesor” i është dhënë një anëtar të stafit akademik të Universitetit të New York Tiranë.

- KPPA ka dhënë 8 tituj “Profesor i Asociuar” në total: 4 tituj “Profesor i Asociuar” i janë dhënë anëtarëve të stafit akademik të UPT-së dhe 4 tituj “Profesor i Asociuar” i janë dhënë anëtarëve të stafit akademik të universiteteve të tjera.

Tabela 27: Numri i titujve akademike të dhënë nga KPPA

FAKULTETI	Titulli akademik “Profesor”	Titulli akademik “Profesor i Asociuar”
FAU, UPT	1	1
FIM, UPT	0	2
FIMIF, UPT	1	1
Universiteti Epoka	1	2
Universiteti Albanian	0	1
Universiteti NYT	1	0
Universiteti E. Çabej	0	1
TOTAL	4	8

SHPËRNDARJA E TITUJVE AKADEMIKË




Figura 25: Shpërndarja e titujve akademike të dhënë nga KPPA

- Dy tituj Profesor i Asociuar dy anëtarëve të stafit akademik të Universitetit EPOKA, Tiranë.
- Një titull Profesor i Asociuar një anëtari të stafit akademik të Universitetit Ismail Qemali, Vlorë.
- Një titull Profesor i Asociuar një anëtari të stafit akademik të Albanian University, Tiranë.

Janë caktuar 24 relatorë për vlerësimin e dosjeve nga pikëpamja e plotësisë së dokumentacionit. Janë ngritur 13 Juri për vlerësimin e dosjeve.

Momentalisht, pranë KPPA-së janë në proces shqyrtimi 14 dosje:

2 dosje për fitimin e titullit “Profesor”.

12 dosje për fitimin e titullit “Profesor i Asociuar”.

➤ Akordimi i Titullit “Doctor Honoris Causa”

Universiteti Politeknik i Tiranës dekoron personalitete të ndryshme të cilët kanë dhënë kontributin e tyre të çmuar në nivel kombëtar dhe më gjerë si dhe për mbështetjen e vazhdueshme dhënë UPT-së.

Gjatë vitit akademik 2021-2022 janë vlerësuar me këtë titull 3 personalitete:

- **Doctor Honoris Causa për Prof. Dr. Dritan Naçe, me motivacionin “Për veprimtarinë e shquar akademike dhe shkencore, për kontributin e vyer dhënë për UPT dhe për vizionin e përbashkët, në ndërkombëtarizimin e arsimit në Shqipëri”.**

Prof. Dr. Dritan Nace, profesor në Departamentin e Optimizimit të Shkencave Kompjuterike pranë Universitetit të Teknologjisë Compiegne, Francë, është një bashkëpunëtor në fushën e industrisë, një ekspert serioz dhe korrekt në projekte dhe organizata të ndryshme në fushën e tij të ekspertizës, një mbështetës i vyer në ndihmë të universiteteve shqiptare si dhe një udhëheqës shkencor i talentuar në drejtim të kualifikimit të kërkuesve të rinj.

Prof. Dr. Dritan Nace, është autor i më se: 68 publikimeve në konferenca ndërkombëtare; 36 artikujve shkencorë në revista ndërkombëtare; bashkëautor në publikime të ndryshme në shumë revista franceze, si dhe autor/bashkëautor i 3 patentave ndërkombëtare, etj.

- **Doctor Honoris Causa për Christophe Guy, me motivacionin “Për veprimtarinë e shquar akademike dhe shkencore, për kontributin e vyer dhënë për UPT dhe për vizionin e përbashkët, në ndërkombëtarizimin e arsimit në Shqipëri”.**

Prof. Dr. Christophe GUY, President i Universitetit të Teknologjisë së Compiegne, është një personalitet i shquar akademik, një drejtues i spikatur i institucioneve universitare në Francë dhe Kanada, një drejtues serioz dhe korrekt i projekteve të ndryshme në fushën e tij të ekspertizës, një bashkëpunëtor i vyer në ndihmë të universiteteve shqiptare si dhe një udhëheqës shkencor i talentuar në drejtim të kualifikimit të kërkuesve të rinj. Mbështetës i zgjerimit të veprimtarisë së kërkimit shkencor në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e Teknologjisë së Informacionit, e konkretizuar kjo në marrëveshje për diploma të dyfishta dhe për shkëmbim të personelit akademik dhe studentëve të UPT-së.

Prof. Dr. Christophe GUY, është autor i më se: 28 kumtesave në konferenca shkencore; 78 artikujve shkencorë në revista shkencore; 44 artikujve shkencorë të referuar në konferenca dhe të botuara në proceeding dhe 60 artikuj në proceeding, bashkëautor i librit “Environnement at sante poublique-Fondements et pratiques”, si dhe autor dhe bashkautor i 8 patentave në fushën e Mjedisit.

- **Doctor Honoris Causa për Thomas Carolus, me motivacionin “Për veprimtarinë e shquar akademike dhe shkencore, për kontributin e vyer dhënë për UPT dhe për vizionin e përbashkët, në ndërkombëtarizimin e arsimit në Shqipëri”.**

Prof. Dr. Ing. Thomas Carolus, Profesor në Universitetin e Siegenit në Gjermani, është një personalitet i shquar akademik, një drejtues i shquar i institucioneve universitare Gjermane, një koordinator serioz dhe korrekt i shumë projekteve europiane në ndihme të universiteteve shqiptare dhe një udhëheqës shkencor i talentuar në drejtim të kualifikimit të kërkuesve të rinj.

Prof. Dr. Ing. Thomas Carolus është autor i më se: 54 kumtesave në konferenca shkencore; 26 artikujve shkencorë në revista shkencore; 3 teksteve mësimore në fushën e makinave fluidike dhe që përdoren si tekste mësimore në të gjitha universitetet gjermane, si dhe autor dhe bashkautor i 17 patentave në fushën e makinave termofluidike dhe sistemeve HVAC, etj.

Titujt “Doctor Honoris Causa” janë dorëzuar në 2 ceremoni solemne, aktivitete të cilat janë nderuar me pjesëmarrjen e akademikëve, profesorëve dhe personaliteteve të shquara të vendit.

DKSH ka përgaritur materialet e nevojshme për propozimin e fillimit të procedurës për dhënien e Titullit “Doctor Honoris Causa” si dhe i’ ka përcjellë ato MAS si dhe ka mbështetur çdo aktivitet gjatë procesit të akordimit të këtij tituli.

➤ **Buletini i Shkencave Teknike**

Buletini i Shkencave Teknike është organ i Universitetit Politeknik të Tiranës dhe vlerësohet si revistë shkencore me Bord Editorial, ku ka si qëllim publikimin e rezultateve të arritura në kërkimin shkencor, bazë e të aplikuar, në fushat e shkencave teknike, të kontribuojë në këmbimin e përvojës dhe kualifikimin e specialistëve në Republikën e Shqipërisë, publikimin e arritjeve të shqipëtarëve në këto fusha jashtë vendit tonë, si punime të tyre ose si bashkëpunime në fusha të ndryshme inxhinierike.

Buletini botohet periodikisht në gjuhën shqipe dhe në raste të veçanta mund të botojë artikuj edhe në gjuhë të tjera me vendim të Redaksisë së tij. Redaksia përbëhet nga nëntë anëtarë ku çdo njësi kryesorë e UPT-së për zgjedh përfaqësuesin e tij dhe anëtari i nëntë zgjidhet automatikisht Drejtori i Drejtorisë së Kërkimit Shkencor dhe Projekteve.

Sekretaria e Redaksisë së Buletinit të Shkencave Teknike të UPT-së, është pjesë e Drejtorisë së kërkimit Shkencor dhe Projekteve.

Gjatë periudhës së raportimit, kjo sekretari ka realizuar këto aktivitete:

- Janë përgatitur shkresa të ndryshme të kësaj redaksie,

- Janë regjistruar në regjistrin e Buletinit artikujt e dorëzuar në Redaksi mbas firmosjes së deklaratës së autorit nga autorët ku pranojnë që punimi i paraqitur është original, nuk është plagjiaturë dhe është botim për herë të parë,
- Janë përgatitur dokumentacionet
- Në bashkëpunim me Kryetarin e Redaksisë janë organizuar mbledhjet e Redaksisë së Buletinit të Shkencave Teknike.
- Janë zbardhur provesverbalet, vendimet e marra nga Redaksia
- Janë përgatitur artikujt për botim në buletinin e radhës.

Konstituimi i redaksisë së re, është bërë në mbledhjen e saj të parë në datën 31 Mars 2022, në të cilën u zgjodh dhe kryetari i kësaj redaksie, i cili u emërua me Vendimin e Rektorit Nr. 82, datë 07.04.2022.

Gjatë vitit akademik 18 Tetor 2021- 14 Tetor 2022, janë organizuar:

- tre mbledhje të Redaksisë së Buletinit të Shkencave Teknike, në të cilat janë aprovuar për botim dy (2) artikuj shkencorë ndërsa gjashtë (6) artikuj të rinj janë në pritje për diskutim në mbledhjet pasardhëse.

Gjatë kësaj periudhe Redaksia ka caktuar përkatësisht:

- tetë (8) recenzues nga stafi akademik i Universitetit Politeknik të Tiranës
- tetë (8) relatorë të përzgjedhur nga anëtarët e Redaksisë, në përputhje me fushën shkencore të tyre si ekspertë për recenzimin dhe relatimin e artikujve

Redaksia e Buletinit ka ngritur grupin e punës për përgatitjen dhe formulimin e Regullores së re të kësaj Redaksie.

Janë në pritje për printim nga kjo Redaksi; artikujt e Konferencës së FIMIF, të vitit 2018, të cilat do të botohen në një botim special, si dhe artikujt e Buletinit të vitit 2020-2021.

Redaksia e Buletinit të shkencave teknike ka lëshuar vertetime për artikujt e miratuar për botim, vertetime për recenzuesit dhe relatorët që kanë kontribuar për vlerësimin e këtyre artikujve.

Redaksia e Buletinit të Shkencave Teknike me mbështetjen e Bibliotekës Shkencore të UPT-së, dhe Bibliotekës së FIE, mori pjesë në “Panairin Mbarëkombëtar të Botimeve Akademike Shkencore, Edicioni I, 22-24 Prill 2022”, i cili u organizua nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë, ku u paraqitën botime shkencore jo vetëm të botuara nga Buletini i Shkencave Teknike të UPT-së por edhe botime shkencore të realizuara nga personeli akademik i Universitetit Politeknik të Tiranës.

➤ Puna në mbështetje të Senatit Akademik i Universitetit Politeknik të Tiranës

Senati është organi kolegjal më i lartë akademik i institucionit të arsimit të lartë, përgjegjës për përmbushjen e misionit të tij, në zbatim të pikës 1, të Nenit 38, të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Senati akademik i UPT përcakton politikat e zhvillimit të UPT, programon dhe bashkërendon veprimtaritë e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor si dhe vlerëson efikasitetin e tyre.

Senati akademik i UPT kryesohet nga Rektori dhe mblidhet periodikisht.

Drejtorja e Kërkimit Shkencor dhe Projekteve mbështet aktivitetin e Senatit Akademik të UPT, nëpërmjet përgatitjes së raporteve teknike, materialeve të ndryshme për komisionet e Senatit dhe veçanërisht të Komisionit të kërkimit shkencor dhe mësimin, mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes së Senatit, zbardhjen e vendimet e marra nga ky i fundit si dhe duke përgatitur shkresat percjellese të vendimeve, të cilat i’a dërgon sipas rastit dhe specifikës, Bordit të Administrimit të UPT-së, njërive kryesore, drejtorive përkatëse të Rektoratit të UPT, etj.

➤ Aktivitete të tjera të DKSHP

- ✓ Drejtorja e Kërkimit Shkencor dhe Projekteve në kuadër të akreditimit të programeve të studimit Bachelor që UPT ofron, ka mbështetur njësitë kryesore të përfshira në këtë proces, duke marrë pjesë në mënyrë aktive në të gjithë takimet e grupeve të punës me vlerësuesit e jashtëm të ASCAL si dhe duke mbuluar fushën e saj të veprimit të Kërkimit Shkencor në nivel institucioni.
- ✓ Pjesëmarrje në Konferencën Kombëtare të Kërkimit Shkencor 2022, “Impakti i Kërkimit Shkencor në ndërkombëtarizimin e institucioneve të arsimit të lartë në Shqipëri”, mbajtur në 28 Mars 2022 dhe organizuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI).

Qëllimi i pjesëmarrjes në këtë Konferencë ishte:

Njohja dhe analiza e stafit të DKSHP me praktikën e mira dhe sfidat me të cilat përballen kërkuesit shqiptarë në rrugëtimin drejt ndërkombëtarizimit dhe pjesëmarrjes në programet e BE për “Kërkimin dhe Inovacionin”.

- ✓ Pjesëmarrje e stafit të DKSHP në “National Info Day”, mbajtur në 21 Dhjetor 2021, takimin informues "Dita Kombëtare Informuese Erasmus+” .

- ✓ Drejtoria e Kërkimit Shkencor dhe Projekteve në bashkëpunim me Kompaninë prestigjioze të publikimeve, Elsevier, organizuan në datën 6 Tetor 2022, work shop-in “Elsevier Research Connect 2022”, me prezantimet e:
Helena Paczuska, Regional Manager of eBooks on ScienceDirect for CEE and Central Asia;
Katarzyna Patyrak, Research Intelligence Solutions Manager for CEE.
Në këtë work-shop morën pjesë personeli akademik i tetë njësive kryesore të UPT dhe u diskutua mbi rrugën që duhet të ndjekë kërkimi shkencor si dhe mbi mënyrat më efikase për rritjen e dukshmërisë së kërkimit shkencor.



- ✓ Panairi i librit “Panairi mbarëkombëtar i librit akademik dhe shkencor” u zhvilluar për herë të parë këtë vit si nismë e përbashkët e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës në periudhën 22-24 prill 2022. Qëllimi i panairit ishte të bënte të njohur arritjet më cilësore në botimet akademike, shkencore dhe universitare. Universiteti Politeknik i Tiranës mori pjesë duke paraqitur botime shkencore, jo vetëm të botuara nga Buletini i Shkencave Teknike të UPT-së por edhe botime shkencore të realizuara nga personeli akademik i Universitetit Politeknik të Tiranës.



Si përfaqësues i Konferencës së Rektorëve, në ceremoninë e hapjes së këtij panairi, fjalën përshëndetëse e mbajti Rektori i Universitetit Politeknik të Tiranës Prof. Dr. Andrea Maliqari.

➤ **Monitorimi i punës së DKSHP**

Rezultatet e aktivitetit të DKSHP janë ndjekur sistematikisht nëpërmjet raportimit periodik të nivelit të arritjes së objektivave dhe indikatorëve të performancës të përcaktuar në Strategjinë e Drejtorisë së Kërkimit Shkencor dhe projekteve.

➤ **Spektori i Projekteve Shkencore dhe Profesionale në Drejtorinë e Kërkimit Shkencor dhe Projekteve**

UPT është përfshirë vazhdimisht në projekte sipas fushave të studimit që ajo mbulon dhe vazhdon të jetë e përfshirë me dhënien e ekspertizës po ashtu edhe në zhvillimin e kapaciteteve.

**Reforming doctoral studies in montenegro and albania – good practice paradigm (MARDS)
2018-2021**

598465-EPP-1-2018-1-ME-EPPKA2-CBHE-SP

Projekti MARDS adreson një nga problemet më të mprehta në sistemet arsimore malazeze dhe shqiptare, studimet e doktoraturës. Objektivi kryesor i projektit është të rindërtojë shkollat e doktoraturës në përputhje me parimet e Salzburgut dhe të krijojë shkolla të përbashkëta pilot të doktoraturës; shkolla të qëndrueshme dhe moderne mes dy vendeve partnere dhe fqinje të cilat do të shërbejnë si shembull i "praktikës së mirë" për Rajonin e Ballkanit Perëndimor. Në tërësi, për të përmirësuar dhe krijuar kapacitete të qëndrueshme në fushën e studimeve të doktoratës në të dy vendet.

Objektivat specifike të projektit MARDS janë:

- të rishikojë politikat ekzistuese kombëtare / standardet për studimet e doktoratës në të dy vendet dhe përputhshmërinë e tyre me praktikën e BE-së,
- të zhvillojë dhe të propozojë një model të ri të studimeve të doktoratës në të dy vendet, të përshtatura sipas eksperiencave të fituara gjatë dekadave të fundit dhe nevojave aktuale dhe të parashikuara të dy vendeve,
- të propozojë një metodë të qëndrueshme të financimit të studimeve të doktoraturës në të dy vendet në nivel kombëtar.
- të krijojnë dy shkolla të përbashkëta të doktoratës "Shkencat Natyrore dhe Teknologjia për një zhvillim të qëndrueshëm" në Mal të Zi (Podgoricë) dhe "Ekonomia dhe Turizmi për një zhvillim të qëndrueshëm" në Shqipëri (Shkodër).

- të krijojë një bashkëpunim të qëndrueshëm me partnerët e BE-së dhe të themelojë Shkollën e Doktoraturës në mënyrë që të ruajë standardet e zhvilluara.

Partnerët në projekt:

Universiteti i Vienës,
Universiteti i Zagrebit;
Universiteti i Maribor,
Universiteti i Banska Bistrica,
Shoqata e profesionistëve në edukimin e doktoraturës.
Universiteti i Malit të Zi (Coordinator),
Universiteti i Donja Gorica,
Ministria e Edukimit e Malit të Zi;
Ministria e Shkencës e Malit të Zi;
Dhoma e Tregtisë e Malit të Zi.
Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”,
Universiteti Politeknik i Tiranës,
Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë,
Universiteti Metropolitan i Tiranës,
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në Shqipëri.

Link zyrtar i projektit: <https://www.mards.ucg.ac.me>
Aktualisht ky projekt mbyllet ne vitin 2022

Higher Education, Enterprise platform for fostering, modernisation and sustainable growth in natural stone industry in Western Balkans (BKSTONE) 2019-2022

610483-EPP-1-2019-1-AL-EPPKA2-CBHE-JP

Ky projekt adreson nevojat e vendeve të Ballkanit për edukim në lidhje me përdorimin e një burimi natyror si guri, i cili është mjaft i rëndësishëm për zhvillimin e ekonomisë në vendet e mesdhetare, si Juglindja e Spanjës, Franca e Jugut, Italia, Greqia apo Turqia. Ka depozita të mëdha mermeri dhe gurësh gëlqerore përgjatë vendeve mesdhetare. Por situata ekonomike dhe politike e vendeve të Ballkanit i ka mbajtur ata jashtë tregut të rëndësishëm global të gurit.

Kësaj duhet ti shtojmë rëndësinë e edukimit në lidhje me restaurimin e ndërtesave historike, shumë prej tyre të ndërtuara me gur. Në disa nga veprat, për shkak të përdorimit të teknikave të vjetra, ndërhyrja në ndërtesë shkakton probleme të rëndësishme në të ardhmen, siç ka ndodhur në vendet më të zhvilluara me ndërhyrjet e kryera në mesin e shekullit të kaluar.

Është e rëndësishme të theksohet se zhvillimi i industrisë së gurit në Ballkan kërkon gjithashtu që zhvillimi të shkojë paralelisht me industrinë, zhvillimin dhe shkëmbimin e njohurive midis faktorëve

akademikë dhe ekonomikë. Kjo kërkon njohuri akoma më të specializuara, aktualisht të padisponueshme në vendet e Ballkanit. Impakti i këtij projekti do të jetë në të gjithë rajonin e Ballkanit i cili do të përfitojë nga eksperiencia e vendeve të BE-së si Italia, Spanja dhe Greqia që janë vende udhëheqëse në këtë fushë.

Partnerët në projekt:

Polytechnic University of Tirana (Coordinator of the project);
University of Elbasan ""Aleksander Xhuvani"";
University of Gjirokastrë ""Eqrem Çabej"";
University of Sarajevo;
University of Mostar;
University Mediterranean Podgorica;
University of Pristine;
Kolegji Nderkombtar per Biznes dhe Teknologji;
University of Coruña;
IES Ribeira do Louro;
Asociación Empresarial de Investigación Centro Tecnológico del Mármol y La Piedra;
Universita Degli Studi di Roma La Sapienza;
C.P.I.P.E. - Escuela Edile di Padova;
National Technical University of Athens;
Transilvania University of Brasov

Link zyrtar i projektit: www.bkstoneproject.com
Aktualisht ky projekt mbyllet ne vitin 2022

Developing Research and Innovation Capacities in Albania and Kosovo (DRIVE)

2019-2022

610307-EPP-1-2019-AL-EPPKA2-CBHE-JP

Projekti synon zhvillimin e kapaciteteve të IAL-ve në Shqipëri dhe Kosovë, për të përmirësuar punën e tyre të kërkimit dhe inovacionit.

Përparësia kombëtare për të dyja këto vende: Përmirësimi i menaxhimit dhe funksionimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë, i vlefshëm për projektet e përbashkëta dhe strukturore. Përkatësisht, përparësia për zhvillimin e kapaciteteve kërkimore dhe inovacionit.

Hulumtimi dhe inovacioni preket nga një mori aktoresh. Projekti ka adoptuar një fokus të mprehtë dhe ka hartuar aktivitetet e tij në mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e tij.

Prandaj, përfituesit e synuar të projektit janë IAL-të pjesëmarrëse nga vendet partnere dhe pjesët përbërëse të tyre: stafi, studentët dhe menaxhmenti. Aktivitetet e planifikuara janë krijuar për të zhvilluar kapacitetet e këtyre grupeve të synuara, por me e rëndësishmja për të zhvilluar struktura të reja, udhëzime, strategji dhe plane veprimi që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në mënyrën e qeverisjes dhe funksionimit të institucionit, duke siguruar kështu qëndrueshmërinë të rezultateve të projektit.

Partnerët në projekt:

POLIS University (Coordinator of the project)

European University of Tirana

Polytechnic University of Tirana

University of Prishtina “Hasan Prishtina”

University of Gjakova “Fehmi Agani”

Universum College

Hamburg University of Technology, Germany

Politecnico di Milano, Italy

Aalborg University, Denmark

Link zyrtar i projektit: <https://driveproject-eu.com/>

Aktualisht ky projekt mbyllet ne vitin 2022

Improving REsearch capacities of Albanian higher education institutions in conservation and restoration of Cultural Heritage (REACH) 2019-2022

610390-EPP-1-2019-1-AL-EPPKA2-CBHE-SP

Projekti ka për qëllim kryesisht të kontribuojë në procesin e pranimit të shqiptarëve në BE, duke mbështetur modernizimin dhe ndërkombëtarizimin e IAL-ve në Shqipëri. Projekti ka dy synime të përgjithshme:

- a) Ti mundësojë Ministrisë së Arsimit strukturë kuadër ku;
- b) IAL-të do të zhvillojnë kapacitetin kërkimor dhe inovacionin.

Për të arritur këtë qëllim, janë vendosur objektivat e mëposhtem specifike:

- Hartimi i udhëzimeve ministrore si kuadër për ndërtimin e një sistemi strukturor të trajnimit kërkimor dhe kërkimit për trashëgiminë kulturore
- Forcimi i aftësive kërkimore të institucioneve shqiptare të arsimit të lartë në fushën e konservimit dhe restaurimit të trashëgimisë kulturore,
- Pajisja i Universiteteve me mjete kërkimore inovative dhe konkurruese si dhe metodologji të fushës;
- krijimi i laboratorëve moderne, të integruara dhe ndërdisiplinare për kërkim;
- transferimi i kërkimit në mësimdhënie, përmes zhvillimit të metodave inovative të kërkimit

Projekti REACH synon në nxitjen e kapaciteteve kërkimore për çeshtje teknike, por edhe në identifikimin e bazave të përbashkëta dhe qasjeve ndërdisiplinore midis departamenteve të ndryshme të institucioneve shqiptare të perfshira.

Partnerët në projekt:

Universiteti i Arteve (Coordinator of the project)

Universiteti Politeknik i Tiranës

Universiteti i Shkodres Luigj Gurakuqi

Akademia e Studimeve Albanologjike

Ministria e Arsimit dhe Sportit

Alma Mater Studiorum Universita di Bologna

Universita degli Studi di Urbino Carlo Bo

Fondazione Flaminia

Escola Superior de Conservacion e Restauracion de Bens Culturais de Galicia

Link zyrtar i projektit: <https://www.reachculturalheritage.eu/#HOME>

**Business driven problem-based learning for academic excellence in geoinformatics (GEOBIZ)
2019-2022**

601225-EPP-1-2019-1-HR-EPPKA2-CBHE-JP

Qëllimi kryesor i projektit GEOBIZ është forcimi i aftësive të institucioneve akademike për t'iu përgjigjur më mirë nevojave të industrisë së gjeoinformatikës në zhvillim në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, Moldavi dhe Mali i Zi me theks në aspektet vijuese:

- Vendosja e formave të reja dhe inovative të bashkëpunimit të biznesit dhe akademisë për të mbështetur bashkëveprimin në proceset mësimore në gjeoinformatike.
- Krijimi i një platforme biznesi-akademie që mbështet përsosmërinë në gjeoinformatikë.
- Zhvillimi i programeve inovative të formimit të mësuesve dhe metodologjive praktike të mësimdhënies dhe përmbajtjes në kurse të bazuara në teknologji në gjeoinformatike të mbështetur në nevojat dhe përvojën e drejtuar nga biznesi.
- Zbatimi i teknikave më të mira në procesin mësimor të gjeoinformatikës

Partneret në projekt:

University of Zagreb

Katholieke Universiteit Leuven

University of Split

University of Applied Sciences

University of Belgrade

University of Novi Sad

Gilab Ltd Belgrade

Polytechnical University Tirana

University of Tirana

Land & Co Ltd Tirana

University of Banja Luka

University of Sarajevo

Gauss Ltd Tuzla

University of Pristina

University for Business and Technology

Technical University of Moldova

Tiraspol State University

University of Montenegro

Link zyrtar i projektit: <http://geobiz.eu/>

Knowledge triangle for a low carbon economy (KALCEA) 2020-2023

618109-EEP-1-2020-1-EL-EPPKA2-CBHE-JP

Objektivi më i gjerë i projektit është të krijojë një qasje sistematike dhe strukturore për zbatimin e parimeve të trekëndëshit të njohurive, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive, informacionit dhe aftësive për shfrytëzimin e përbashkët të kapaciteteve kërkimore për rritje të qëndrueshme bazuar në inovacionin në WBC. Ne duam të krijojmë integrimin institucional të arsimit, kërkimit dhe inovacionit.

Objektivat specifike janë:

- Krijimi i një rrjeti të strukturuar shumë-shtetesh midis IAL-ve dhe sektorit të industrisë në vendet e WBC me synimin për të shfrytëzuar vlerën e plotë të bashkëpunimit dhe bashkëpunimit (inovacioni hapur), duke bërë një ndikim në akademinë, biznesin dhe shoqërinë.
- Vendosja e 5 Njohurive - Qendrave të Inovacionit në IAL të WBC me qëllim menaxhimin e veprimtarive të trekëndëshit të njohurive në WBC, mbështetur nga platforma inovative e bashkëpunimit
- Krijimi dhe implementimi i një programi profesional në bashkëpunim me sektorin e industrisë në fushën e energjisë së qëndrueshme në 3 IAL të WBC të përfshira
- Të rritet ndërgjegjësimi për rëndësinë e trekëndëshit të njohurive në Shqipëri, Bosnjë dhe Kosovë

Partnerët në projekt:

National & Kapodistrian University of Athens

Technical University of Vienna

Riga Technical University

University Of Novi Sad

Creative Thinking Development

University of East Sarajevo

International BURCH University

University Dzemal Bijedic Mostar

Albenecon

University of Pristina in Kosovska Mitrovica

Universum College

European University of Tirana

Polytechnic University of Tirana

Aleksander Moisiu University Durres

Kompanija ZD IRCE a.d. Istocno Sarajevo

Link zyrtar i projektit: <https://kalcea.com/about/>

ENGINEERING CURRICULA MODERNISATION IN RENEWABLE ENERGY IN ALBANIAN UNIVERSITIES (ENGINE) 2020-2023

619339-EPP-1-2020-1-AL-EPPKA2-CBHE-JP

Modernizimi i programeve mësimore në inxhinierinë për energjitë e rinovueshme në universitetet shqiptare të synuara dhe kolegjet e larta teknike, përmes programeve të reja VET dhe programeve të azhornuara BSc në përputhje me zhvillimin e ri në zonë, kërkesën e tregut të punës dhe mundësitë për lëvizje virtuale përmes e-mësimit siguroar nga TIK.

Ky projekt synon posaçërisht të:

- Analizojë nevojat arsimore në inxhinieri për energjitë e rinovueshme përmes analizës së problemeve dhe punës, dhe të përcaktojë njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e nevojshme të inxhinierëve në sektor në lidhje me rezultatet e të nxënësve.
- Të hartojë planprogram dhe përmbajtje kursi dhe vlerësim për lëndët e detyrueshme dhe me zgjedhje në inxhinieri elektrike për energji të rinovueshme për të përmbushur nevojat e përdoruesit.
- Të zhvillojë kurse të reja të e-mësimit me strukturë modulare për kurrikulat e reja të universiteteve partnere dhe të krijojë një platformë dhe Procedura për ndarjen e njohurive midis IAL-ve në vendet partnere dhe akademisë evropiane dhe studentëve.
- Të inovojmë pajisjet laboratorike dhe të kryejmë një test pilot dhe të fillojmë implementimin e moduleve / kurseve të përbashkëta gjatë vitit të fundit të projektit.

Partnerët në projekt:

Polytechnic University of Tirana [UPT] Coordinator
Katholieke Universiteit Leuven [KU Leuven]
Technical University of Sofia [TUS]
National and Kapodistrian University of Athens [NKUA]
Kadir Has University [KHAS]
European University of Tirana [UET]
'Aleksander Moisiu' University of Durrës / UAMD
Professional College of Tirana [KPT]
Albenecon
Quality Assurance Agency in Higher Education [ASCAL]
Creative Thinking Development [CRE.TH1.DEV]

Link zyrtar i projektit: <https://engineproject.eu>

Comprehensive RISK assesment of basic services and transport InfraStructures (CRISIS) 2020-2022

NUMBER — 101004830

The main objective of CRISIS is to provide a qualitative basis for the development of a collaborative approach to prevention and preparedness for disaster risks and management in cross border countries located in the Western Balkan Region. This will be achieved by three main courses of action:

1. Assessment of natural and human-induced cross-border risks of basic services and transport infrastructure;
2. Collection, harmonization, and improvement of existing data and tools for assessment of critical assets;
3. Development and testing of the methodology incorporated in the web-based platform for rapid screening of vulnerable infrastructure nodes within a region, accounting for optimal resource allocation and emergency response planning, while engaging local authorities and increasing awareness of the local communities.

CRISIS project aims at improving the disaster and emergency management through building a harmonized and efficient system for risk assessment of basic services and transport infrastructure in the targeted cross-border region.

The main project activities include:

1. Cross-border multi hazard assessment
2. Needs assessment
3. Crossborder multi-risk assessment.
4. Development of cross-border web base platform for risk assessment and management.

Participants:

1. IZIIS – Institute of Earthquake Engineering and Engineering Seismology, Ss. Cyril and Methodius university in Skopje - Leader
2. CMC – Government of Republic of N. Macedonia, Crisis Management Centre
3. UPT-FCE - Polytechnic University of Tirana, Faculty of Civil Engineering
4. AUTH – Aristotle University of Thessaloniki, Greece
5. EUCENTRE - European Centre for Training and Research in Earthquake Engineering, Pavia, Italy

Në vitin 2022 u aplikua për projekte të reja, referuar Programit të ri **Erasmus 2027**.

Si më poshtë është tabela përmbledhëse e projekteve të aplikuara me suportin konstant të zyrës së projekteve shkencore, ku evidentohet qartë edhe numri i atyre që kanë fituar. Projektet e fituara do të koordinohen nga personat e kontaktit, ndërkohë që zyra do të ushtrojë një kontroll periodik për të ndjekur dhe monitoruar implementimin e tyre. Të gjitha projektet e reja të fituara do fillojnë të implementohen në vitin 2023.

Nr.	Fakulteti	Akronimi	ID	Lloji I tematikes	Roli	Contact person of the coordinator	Roli	Contact point UPT	Status
					Coordinator		Partner		
1	FTI	DL4WB		Strand 2	UPT	Evis Trandafili		Evis Trandafili	deleted
2	UPT	TRACE	101082774	Strand 3	Universiteti Polis	Flora Krasniqi	UPT	Alma Afezulli	rejected
4	FIN	IFUTURE	101082815	Strand 2	Universiteti i Tiranës	Elona Pojani	UPT	Oltion Marko	invited
5	FGJM	RESTART	101082855	Strand 2	Sveuciliste U Dubravniku	Nebojsa Stojcic	UPT	Aida Bode	rejected
6	FTI	UP	101082862	Strand 2	Universiteti I Prishtines	Kyvete Shatri	UPT	Elinda Mece	reserve list
8	FIM	DERHE	101082066	Strand 2	Univerza V Ljubljani	Tomaz Berlec	UPT	Valma Prifti	rejected
9	FTI	EMECISplus	101082389	Erasmus Mundus Joint Masters	Universita Degli Studi I Genova	Simona Sacone	UPT	Elinda Mece	rejected
10	FIM	DGTRANS	101082187	Strand 2	University of Mitrovica	Nebojsa Arsic	UPT	Genti Guxho	invited
11	FIM	INTEC	101081873	Strand 2	FH Joanneum Gesellschaft MBH	Kurt Steiner	UPT	Odhisea Koca	invited
12	FIN	SmartWB	101081724	Strand 2	Javna Ustanova Univerzitet Crne Gore Podgorica	Marija Jevric	UPT	Bilbil Nurce	invited
13	FIN	B-MARE	101083050	Strand 2	Universiteti Aleksander Moisiu Durres	Dorinela Cupi	UPT	Alma Afezulli	rejected
14	FTI	IoT-ECO	101083018	Strand 2	University of Sofia	Galia Marinova	UPT	Enida Sheme	invited
15	FTI	ARTISAN	101083016	Strand 2	Universiteti I Prishtines	Eliot Bytyci	UPT	Bojken Shehu	rejected
16	FAU	DArch	101083155	Strand 2	Universiteti Polis	Elona Karafili	UPT	Alma Afezulli	rejected
17	FTI	ERA Cyber-Sec in AL	101083093	Strand 1	Universiteti Luarasi Sh.p.k	Ani Dasho	UPT	Elinda Mece	rejected
18	FIM	Ret4web	101082714		Universiteti Europian I Tiranës	Kebjana Haka	UPT	Majlinda Alcani	rejected
19	FTI	EUSIS	101085185	JMO			UPT	Iglli Tafa	invited
20	FTI	Digi4Wearables	Sep-210854476	CB-VET	Centro Tecnologico de Calçado de Portugal	Agnes Vitaniotou	UPT	Tatjana Spahiu	invited
21	FIMIF	ISTA-EU	101085776	JMO				Joan Jani	invited
22		ReScale	101037653	H2020-LC-GD-2020-3			UPT	Elfrida Shehu	rejected
23		AI4LT					UPT	Elinda Mece	rejected
24		INOVILLA	101084545	HORIZON-CL6-2022-COMMUNITIES				Florian Nepravishta	rejected
25		TCIA database AL101088890ERC-2022-COG						Altin Gjevori	rejected
26		ISRA	101101255	UCPM-2022-PP				Neritan Shkodrani	Invited

VI. ANALIZA E PUNËS KËRKIMORE SHKENCORE TË REALIZUAR GJATË VITIT AKADEMIK 2021-2022

Pikat e forta

- Me Vendim Nr. 01, datë 07.01.2022, “Për Akreditimin periodik të Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti Politeknik i Tiranës”, UPT mori Akreditimin Institucional me kohëzgjatje 6 (gjashtë) vite.
- Hapja, pas një kohe të gjatë, e programeve të studimit të ciklit të tretë “Doktoratë”. Aktualisht në UPT janë hapur 9 programe studimi të ciklit të tretë “Doktoratë”.
- Cilësia e lartë e personelit akademik me tituj akademike dhe grada shkencore të angazhuar në mësimdhënie dhe kërkim shkencor (2 Akademikë, 48 Profesorë, 63 Profesorë të Asociuar dhe 183 Doktorë), të cilët përbëjnë një garanci në drejtim të realizimit të punës kërkimore shkencore.
- Kërkesa në rritje për marrjen e titujve dhe gradave akademike, si një faktor që ka ndikuar në rritjen sasiore dhe cilësore të punës së kërkimit shkencor”.
- Evidentimi dhe intensifikimi i dhënies së gradave dhe titujve akademikë kandidatëve stafe akademike të institucioneve të tjera, të cilët kanë qenë nën udhëheqjen e profesorëve të UPT-së, është shprehje e kapaciteteve të larta, vlerave dhe mundësive të UPT-së, duke kontribuar në nivel kombëtar në rritjen e cilësisë së Kërkimit Shkencor në rang vendi.
- Rritja në sasi dhe cilësi e veprimtarisë kërkimore shkencore e cila pasqyrohet qartë në:
 - rritjen e numrit të botimeve si autor i parë, si në nivel njësie kryesore ashtu edhe në nivel institucioni,
 - rritjen pothuajse dyfish të numrit të botimeve si bashkë autor, si në nivel njësie kryesore ashtu edhe në nivel institucioni,
 - rritjen e numrit të projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare si në nivel njësie kryesore ashtu edhe në nivel institucioni,
 - rritjen e numrit të pjesëmarrjes së personelit akademik në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare,
 - rritja e numrit të aplikimeve për financim të kërkimit shkencor nëpërmjet projekteve të financuara nga fonde kombëtare dhe ndërkombëtare,
 - rritjen me dyfish të numrit të pjesëmarrjes së personelit akademik në aktivitete kombëtare,
 - rritjen me dyfish të numrit të pjesëmarrjes së personelit akademik në aktivitete ndërkombëtare, etj.
 - organizimi i 3 konferencave ndërkombëtare nga njësitë kryesore të UPT-së
- Kërkimi shkencor konsiderohet pjesë e pandarë e aktivitetit të përditshëm të stafit akademik të UPT-së duke qenë se arritjet kërkimore dhe shkencore të tij janë të lidhura drejtpërdrejt me

përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, me përditësimin e informacionit shkencor që u përcillet studentëve në auditor dhe me rritjen akademike të stafit në kërkimit shkencor.

- Rritja e veprimtarisë ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor, nëpërmjet pjesëmarrjes në programet dhe projektet kërkimore kombëtare, evropiane dhe rajonale dhe më gjerë.
- Rritja e nivelit të bashkëpunimit me universitete dhe institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit, konkretizuar me rritjen e numrit të marreveshjeve si dhe me rritjen e numrit të mobiliteteve të personelit akademik, administrativ si dhe me rritjen e numrit të studentëve të UPT-së, si një ndër aspektet e rëndësishëm të synimit drejt ndërkombëtarizimit të kërkimit shkencor.
- Përfshirja dhe angazhimi i studentëve të doktoratës në mësimdhënie me qëllim ndarjen e përvojës dhe rezultateve të projektit të tyre shkencor të doktorates me studentët.
- Ofrimin e ekspertizës në fushat me interes për zhvillimin e vendit.

Pikat e dobëta

- Rritja e fondeve për kërkimin shkencor dhe shërbimet në mbështetje të tij.
- Shpërndarja jo uniforme e titujve akademike ndër fakultetet e UPT-së.
- Rritja e ngarkesës mësimore, e ka orientuar personelin akademik më tepër drejt aktivitetit didaktik duke krijuar vështirësi në angazhimin e tij në aplikime apo angazhime në projekte.
- Përfshirja më e madhe e studentëve në konferenca/aktivitete të kërkimit shkencor.
- Baza laboratorike e cila ka nevojë për rinovim dhe modernizim në mënyrë që të mund t'i përgjigjet nevojave dhe kërkesave që paraqit sot kërkimi shkencor.
- Akreditimi i laboratorëve të kërkimit shkencor
- Ofrimin e programeve të studimeve të formimit të vazhduar, si formë e të mësuarit gjatë gjithë jetës.
- Organizimin i aktiviteteve shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare (konferencanë, seminare, workshope, etj) në nivel njësie kryesore/njësie bazë), minimalisht një herë në 2 vjet.
- Mungesa në infrastrukturë, si pasojë e dëmtimit të godinave nga tërmeti.